www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 134

Tiranë – E enjte, 30 korrik 2015

PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr. 65/2015 datë 2.7.2015 — Për miratimin e përjashtimeve nga taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti i kushtëzuar, sipas marrëveshjes së garancisë, në lidhje me marrëveshjen e huas, për financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e rrjeteve numerike (digjitale) DVB-T2 të transmetuesit publik (RTSH)..... 6807

LIGJ
Nr. 65/2015

PËR MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË NGA IMUNITETI I KUSHTËZUAR, SIPAS MARRËVESHJES SË GARANCISË, NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E HUAS, PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E RRJETEVE NUMERIKE (DIGJITALE) DVB-T2 TË TRANSMETUESIT PUBLIK (RTSH)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimin e përjashtimeve nga taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti i kushtëzuar, sipas marrëveshjes së garancisë, në lidhje me marrëveshjen e huas, për financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e rrjeteve numerike (digjitale) DVB-T2 të transmetuesit publik (RTSH), sipas marrëveshjes së garancisë, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2015

KRYETARI
Ilir Meta

MARRËVESHJE GARANCIE
E DATËS_____ NDËRMJET DEUTSCHE BANK AKTIENGESELLSCHAFT, FRANKFURT AM MAIN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (GARANTUESI), TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SAJ E FINANCAVE, TIRANË NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E HUAS NR. 1, NË SHUMËN 20,064,590.55 EURO TË DATËS_____ NDËRMJET DEUTSCHE BANK AKTIENGESELLSCHAFT, FRANKFURT AM MAIN (HUADHËNËSI) DHE RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR, TIRANË (HUAMARRËSI) PËR QËLLIM TË PROJEKTIT TË DIGJITALIZIMIT TË RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR

Hyrje

Deutsche Bank Aktiengesellschaft, Frankfurt am Main (Huadhënësi), me marrëveshjen e datës_____ (Marrëveshja e Huas) vë në dispozicion të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë, Republika e Shqipërisë (Huamarrësi) një Hua që nuk tejkalon vlerën 20,064,590.55 euro (në fjalë: njëzet milionë e gjashtëdhjetë e katër mijë pesëqind e nëntëdhjetë 55/100 euro) kundrejt garancisë sipas kërkesës së parë të Garantuesit. Në përputhje me këtë, Garantuesi lëshon këtë Marrëveshje Garancie, me qëllim që të garantojë se Huadhënësi përfiton rimbursimet e të gjitha shumave, të cilat janë përcaktuar se do të rimbursohen nga Huamarrësi, sipas Marrëveshjes së Huas, në monedhën dhe vendin e parashikuar në Marrëveshje sipas kushteve të maturimit, të përcaktuara apo të përshpejtuara

(Debia), duke nënkuptuar shumën neto pa asnjë zbritje apo tatim të çfarëdo natyre dhe pavarësisht rrethanave faktike apo ligjore (duke përfshirë, por pa u kufizuar te forca madhore apo çdo ngjarje ose veprim që vonon ose pengon shkëmbimin ose transfertat apo arkëtimet nga Huadhënësi në llogarinë për të cilën është rënë dakord nga Huadhënësi) dhe motive për arsye të të cilave Huamarrësi mund të mos kryejë pagesën e Debisë.

Termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas njihen nga Garantuesi. Termat e përdorur në këtë Marrëveshje Garancie dhe të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas përmbajnë kuptimet që u jepen atyre në to, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe.

1. Garancia dhe shuma e garantuar

Garantuesi, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar, garanton pagesën për Huadhënësin, në Frankfurt am Main në monedhën e zbatueshme euro, pjesë e Debisë çdo shumë deri në 22,071,049.60* euro (me fjalë: njëzet e dy milionë e shtatëdhjetë e një mijë e dyzet e nëntë 60/100), duke përfshirë ato shuma që i korrespondojnë interesave dhe të gjitha shumat për të cilat është rënë dakord që të paguhen nga Huamarrësi kundrejt konfirmimit me shkrim nga ana e Huadhënësit ose në rrugë telematike në mënyrë që shuma e kërkuar nga Garantuesi sipas kësaj marrëveshjeje të jetë e barabartë me debinë, që nuk ka paguar Huamarrësi. Pagesa, sipas kësaj marrëveshjeje, do të depozitohet në llogarinë e Huadhënësit me nr. 0048322 02 në Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main, Swift DEUTDEFF / IBAN DE88 5007 0010 0004 8322 02, (ref. Radio Televizioni Shqiptar, Marrëveshja e Huas nr. 1, Rohde&SchwarzGmbH&Co. KG, në vëmendje të z. Emmes) ose në një llogari tjetër të njoftuar nga Huadhënësi, në euro, pa asnjë zbritje apo shume të mbajtur.

2. Pagesa me kërkesë të parë

Garantuesi krediton menjëherë shumën, sipas kësaj Marrëveshjeje, në momentin e kërkesës së parë nga Huadhënësi dhe konfirmimit, me shkrim ose në rrugë telematike, që shuma që i kërkohet Garantuesit të jetë e barabartë me Debinë (ose me një pjesë të saj), të cilën Huamarrësit nuk e ka shlyer në afatin e maturimit.

3. Detyrimi parësor, i pavarur

Kjo Marrëveshje Garancie përbën detyrimin parësor dhe të pavarur të Garantuesit për të rimbursuar Huadhënësin në përputhje me kushtet e saj, në të gjitha rrethanat, pavarësisht vlefshmërisë, ligjshmërisë apo zbatueshmërisë së Marrëveshjes së Huas dhe pavarësisht të gjitha kundërshtimeve, përjashtimeve apo mbrojtjeve nga ana e Huamarrësit apo palëve të treta.

4. Garancia për rimbursim

Huadhënësit nuk i kërkohet fillimisht të pretendojë rimbursim, të ngrejë padi kundër apo të ekzekutojë ndonjë pretendim apo garanci të dhënë nga Huamarrësi ose çdo person tjetër para se të bëjë kërkesë nga Garantuesi sipas Marrëveshjes.

5. Përjashtimi i mbrojtjeve specifike

Kjo Marrëveshje Garancie dhe detyrimet e Garantuesit sipas saj nuk kushtëzohen nga marrëdhënia ligjore midis Huamarrësit dhe Huadhënësit dhe janë të pavarura dhe të zbatueshme pavarësisht nga:

a) çdo e metë në dispozitat e Marrëveshjes së Huas;

b) çdo mungesë apo mangësi në vendimet e korporatës në lidhje me Debinë;

c) çdo përfaqësim i pamjaftueshëm i Huamarrësit;

d) çdo mungesë licencash apo autorizimesh të tjera ose çdo pengesë apo kufizime faktike apo ligjore që ekzistojnë apo paraqiten në shtetin e Huamarrësit (duke përfshirë, por pa u kufizuar tek forca madhore ose çdo ngjarje apo veprim që vonon apo pengon shndërrimet në transferta apo arkëtime nga Huadhënësi në llogarinë për të cilën është rënë dakord nga Huadhënësi);

e) çdo marrëveshje e lidhur ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit që lidhet me Debinë, duke përfshirë të gjitha zgjatjet e afatit të rimbursimit dhe çdo riskedulim apo ristrukturim të Debisë, pavarësisht nëse Garantuesi ka dhënë pëlqimin e tij;

f) marrja, ekzistenca, ndryshimi apo çlirimi i çdo kolaterali tjetër që i është lëshuar Huamarrësit për Debinë, dhe marrëdhënia ligjore e Huamarrësit me çdo ofrues të kolateralit të sipërpërmendur;

g) çdo e drejtë e Huamarrësit për të zgjidhur Marrëveshjen e Huas; dhe

h) çdo e drejtë që Huadhënësi mund të ketë për kompensimin e Debisë kundrejt një kundërpretendimi të Huamarrësit.

6. Tatimet

Çdo shumë që paguan Garantuesi sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet e çliruar dhe e shlyer dhe pa asnjë zbritje të tatimeve të mbajtura në burim. Tatimet e mbajtura në burim janë tatime, tarifa apo taksa qeveritare të çfarëdo natyre, të cilat vendosen apo mblidhen nga ose në emër të shtetit të Garantuesit dhe që zbriten nga çdo rimbursim sipas kësaj Marrëveshje dhe/ose sipas Marrëveshjes së Huas. Në rast se zbritja e tatimeve të mbajtura në burim kërkohet me ligj, atëherë Garantuesi paguan ato shuma shtesë që mund të jenë të nevojshme, me qëllim që shumat neto të marra nga Huadhënësi pas zbritjeve të jenë të barabarta me shumën që do të merrej nëse një zbritje e tillë nuk do të kërkohej.

7. Kompensimi i monedhës

Pagesat e kryera nga Garantuesi ndaj Huadhënësit, në zbatim të një vendimi ose urdhri të lëshuar nga gjykata penale ose administrative, në monedhë të ndryshme nga ajo e Garancisë (Monedha e Garancisë) përbën përmbushje të detyrimit të Garantuesit vetëm në masën që shuma e Monedhës së Garancisë të cilën Huadhënësi, menjëherë pas marrjes së rimbursimit në monedhën në fjalë, do të ishte i aftë të blinte me shumën e marrë në këtë mënyrë në një treg të njohur të këmbimit valutor. Në rast se një shumë e tillë do të ishte më e vogël se shuma e detyruar e shprehur në Monedhën e Garancisë sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, në atë kohë si një detyrim më vete dhe i pavarur, që bëhet shkak për ngritje pretendimi, Garantuesi ka detyrimin të paguajë diferencën.

8. Kufizimi i kalimit të përgjegjësive

Në masën që Debia nuk është shlyer dhe ka mbetur pa u rimbursuar ndonjë shumë, sipas Marrëveshjes së Huas, Garantuesi nuk merr përsipër të ngrejë pretendimet që mund të ketë kundër Huamarrësit për arsye të ushtrimit të detyrimeve të Garantuesit sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, qoftë sipas kontratës apo ligjit, derisa Debia të shlyhet dhe të gjitha shumat që i detyrohen Huadhënësit sipas Marrëveshjes së Huas të merren apo kompensohen plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme. Çdo shumë që Garantuesi arkëton apo kompenson nga Huamarrësi mbahet në garanci mirëbesimi dhe i paguhet menjëherë Huadhënësit. Në rast se Garantuesi paguan Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje, Garantuesi do të kalohet në të drejtat e Huadhënësit kundrejt Huamarrësit pasi Debia të jetë shlyer dhe të gjitha shumat që i takojnë Huadhënësit sipas Marrëveshjes së Huas të jenë marrë apo kompensuar plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme nga Huadhënësi.

9. Shpërndarja/ndryshimi i strukturës

Detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie mbeten në fuqi pavarësisht shpërndarjes ose ndryshimit në strukturën apo formën juridike të Huamarrësit.

10. Ristrukturimi

Huadhënësi, pa pëlqimin e Garantuesit, gëzon të drejtën e riskedulimit apo ristrukturimit të principalit, interesave dhe shumave të tjera të detyrueshme sipas Marrëveshjes së Huas, të çlirojë Huadhënësin nga detyrimet e tij dhe/ose të pranojë një debitor të ri nëse, për arsye të cilat Huadhënësi i çmon të rëndësishme, Huadhënësi ose shoqëritë e tjera të grupit Deutche Bank bien dakord për masa të ngjashme edhe për sa i përket Huadhënësit ose kreditë e tyre të tjera të shtrira tek entet në shtetin e Huamarrësit. Këto masa nuk ndryshojnë përgjegjësinë e Garantuesit sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, dhe Garantuesi merr përsipër t'i paguajë plotësisht Huadhënësit me kërkesë të parë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, të gjitha shumat dhe në një afat të tillë sikur të ishin maturuar nëse Marrëveshja e Huas dhe Debia do të kishin mbetur në fuqi dhe të pandryshuara. Garantuesi nuk është i detyruar të japë pëlqimin në lidhje me kushtet dhe dokumentacionin e riskedulimit, ristrukturimit, çlirimit apo sipërmarrjes së borxhit.

11. Para të reja

Nëse Huadhënësi bie dakord në lidhje me ristrukturimin e borxhit apo për të shmangur një ristrukturim të tillë, për t'i dhënë Huamarrësit kredi të reja (para të reja) ose enteve të tjera të sektorit publik apo privat në vendin e Huamarrësit dhe nëse pjesëmarrja e Huadhënësit në para të reja do të llogaritej mbi bazën e kredive të reja të dhëna nga Huadhënësi dhe/apo shoqëri të tjera të grupit të

Deutche Bank për Huamarrësin apo ente të tjera, Garantuesi garanton në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, atë pjesë të pretendimeve për principalin, interesat, kostot, shpenzimet, tarifat dhe shuma të tjera që duhen paguar në lidhje me paratë e reja nëpërmjet të cilave është rritur pjesëmarrja e Huadhënësit në paratë e reja në përputhje me Debinë, pavarësisht nëse Huadhënësi është i detyruar me ligj për të marrë pjesë në ristrukturimin e parave të reja. Në këtë rast, kërkohet pëlqimi i Garantuesit për kushtet e dokumentacionit të parave të reja.

12. Informacioni

12.1 Garantuesi i jep Huadhënësit një listë firmash të autorizuara të personave të autorizuar për të bërë të gjitha deklaratat për Huadhënësin në emër të Garantuesit, në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie. Garantuesi duhet gjithmonë të mbajë të përditësuar listën e firmave të autorizuara.

12.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje Garancie bëhen dhe vendosen vetëm me shkrim. Nga kjo kërkesë mund të hiqet dorë vetëm me marrëveshje me shkrim.

Të gjitha deklaratat dhe njoftimet komunikohen nëpërmjet shkresave ose me transmetim elektronik në adresat e mëposhtme:

Për Garantuesin:
Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave
Rr. "I. Qemali", nr. 11, Tiranë, Shqipëri
Telefaks: _____

ose për Huadhënësin:
Deutsche Bank AG
Structured Trade&Export Finance
Taunusanlage 12 D-60325 Frankfurt
Republika Federale e Gjermanisë
Telefaks: +49-69-910-34636, -32610 ose -39765

Çdo ndryshim në emrat dhe adresat e mësipërme të biznesit do të jetë detyrues vetëm pas marrjes nga Huadhënësi ose nga Garantuesi, përkatësisht, të njoftimit ose të dokumenteve që evidentojnë një ndryshim të tillë.

12.3 Garantuesi njofton Huadhënësin pa vonesë për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë zbatimin e duhur të Marrëveshjes së lidhur të Huas ose të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

12.4 Derisa të gjitha detyrimet e marra përsipër në lidhje me Marrëveshjen e Huas të jenë përmbushur, Garantuesi do t'i japë Huadhënësit rregullisht:

12.4.1 sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda 180 ditëve pas përfundimit të çdo viti financiar, një kopje të raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për atë vit financiar;

12.4.2 sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda muajit dhjetor të vitit të mëparshëm, buxhetin shtetëror vjetor të Garantuesit për çdo vit kalendarik;

12.4.3 sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda 180 ditëve pas përfundimit të çdo viti financiar, pasqyrat financiare të Garantuesit për secilin vit financiar, duke përfshirë informacion në detaje të arsyeshme në lidhje me:

a) bilancin ndërkombëtar të pagesave të Garantuesit për atë vit financiar;

b) i) titujt (mbajtjet) zyrtarë prej ari; ii) SDR (të drejtat speciale të tërheqjes); iii) Pozicionet e rezervave në Fond; iv) Kursin e këmbimit valutor, i cili është në pronësi ose mbahet nga Garantuesi, Banka e Shqipërisë apo ndonjë autoritet tjetër monetar i Garantuesit (SDR-të, pozicionet e rezervave në Fond dhe kursi i këmbimit valutor do të interpretohen sipas kuptimit të dhënë atyre nga FMN-ja); dhe v) shumën (siç është raportuar nga Banka e Shqipërisë) e borxhit të jashtëm të Garantuesit në fund të atij viti financiar; dhe

c) produktin e brendshëm bruto të Garantuesit për atë vit financiar (duke përfshirë ndarjet sipas sektorëve).

13. Transferimi

Huadhënësi ka të drejtë të transferojë të drejtat dhe pretendimet e tij të pagesave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Garancie së bashku me pretendimet përkatëse sipas Marrëveshjes së Huas, në tërësi ose pjesërisht, te palë të treta pa pëlqimin e Garantuesit dhe të japë çdo informacion të nevojshëm për ta, para dhe pas çdo transferimi.

14. Marrja e përgjegjësive

14.1 Garantuesi siguron që të gjitha detyrimet e tij të rimbursimit në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie renditen të paktën të barabarta, në çdo kohë, me të gjitha debitë e jashtme, të vjetra, aktuale apo të ardhme (domethënë, debi ndaj kreditorëve të huaj). Nëse dhe në masën që Garantuesi siguron debi të jashtme nëpërmjet një pengu mbi asetet e tij apo asetet e filialeve të tij, atëherë Garantuesi merr përsipër të sigurojë debinë, në mënyrë të barabartë dhe me përqindje, nëpërmjet pengut mbi asetet e tij apo aseteve të filialeve të tij ose nëpërmjet çdo kolaterali tjetër që pranohet nga Huadhënësi.

14.2 Garantuesi: i) merr përsipër se as Garantuesi dhe as ndonjë nga filialet e tij ose zyrtarët përkatës, drejtorët, punonjësit ose agjentët që veprojnë në emër të tij nuk do të ofrojnë, japin, insistojnë në, marrin ose kërkojnë ndonjë pagesë të paligjshme apo avantazh të padrejtë për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi në lidhje me Projektin; dhe ii) deklaron dhe garanton se asnjë nga veprimet e papërshtatshme apo të paligjshme të lartpërmendura nuk ka ndodhur para datës së lëshimit të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

14.3 Garantuesi kupton se çështjet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Garancie janë veprime private dhe tregtare sipas legjislacionit gjerman. Për shkak të faktit se Garantuesi është Sovrani i Republikës së Shqipërisë dhe në masën që Garantuesi, në çdo juridiksion, mund të gëzojë të drejtën, për vete apo për asetet e veta apo fitimet, për të pretenduar imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi (qoftë i lidhur me ekzekutimin, para dhënies së një gjykimi ose akordimeve apo vendime të tjera) ose procese të tjera gjyqësore, duke përfshirë, në lidhje me zbatimin e vendimit të arbitrazhit, dhe për aq sa një imunitet i tillë (pavarësisht nëse pretendohet) mund t'i atribuohet Garantuesit, në një juridiksion të tillë ose aseteve apo të ardhurave të tij, atëherë Garantuesi, sipas kësaj Marrëveshjeje, bie dakord në mënyrë të pakthyeshme që të mos pretendojë një imunitet të tillë dhe, me anë të kësaj Marrëveshjeje, e heq këtë imunitet në shkallën më të plotë që e lejojnë ligjet e juridiksionit në fjalë. Nëpërmjet një përjashtimi, Huadhënësi nuk heq imunitetin në lidhje me ekzekutimin e një vendimi të arbitrazhit që lidhet me: i) "godinat e misionit" aktuale apo të ardhme, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në vitin 1961, "godinat konsullore" aktuale apo të ardhshme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të nënshkruar në vitin 1963 ose të tjera që përdoren nga misioni diplomatik i Shqipërisë; ii) çdo pasuri të paluajtshme, sipas parashikimeve të nenit 3, paragrafët 1-3, të ligjit shqiptar nr. 8743 të datës 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar; dhe iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është maturuar dhe shlyer në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas të drejtës publike, traktateve ndërkombëtare, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

14.4 Të gjitha taksat, tarifat dhe shpenzimet e tjera në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie (të tilla si taksat dhe tarifat e avokatëve), duke përfshirë kostot që lindin në lidhje me ndonjë detyrim të kësaj Marrëveshjeje të Garancisë, do të përballohen nga Garantuesi. Tatimet e lartpërmendura, tarifat dhe shpenzimet duhet të dokumentohen në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësi.

15. Të ndryshme

Garantuesi përfaqëson dhe garanton se kjo Marrëveshje Garancie është e detyrueshme, e vlefshme dhe e zbatueshme ndaj Garantuesit, në përputhje me kushtet e saj. Garantuesi konfirmon se ai ka ndërmarrë dhe do të vazhdojë të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se çdo shumë e pretenduar nga Huadhënësi nga Garantuesi mund të transferohet tek Huadhënësi menjëherë, pa asnjë lloj zbritje, kosto ose tarifa të tjera. Garantuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar informacion nga Huadhënësi në lidhje me Marrëveshjen e Huas dhe Debinë.

16. Afati

Kjo Garanci hyn në fuqi që nga data e lëshimit të saj dhe përfundon pasi të gjitha shumat e shprehura të jenë të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin si rezultat i borxhit, të jenë pranuar

plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme nga Huadhënësi.

Megjithatë, në rast se pas kësaj Huadhënësit i lind përgjegjësia për të kthyer paratë e marra në pagesën e borxhit, si rezultat i ndonjë falimentimi, likuidimi ose procedure të ngjashme që ndikon te Huamarrësi, kjo Garanci do të rivendoset në afat dhe do të hyjë në fuqi përsëri pavarësisht skadimit të afatit.

17. Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Garancie do të jetë e pazbatueshme ose e pavlefshme, dispozitat e tjera të saj do të mbeten në fuqi. Çdo dispozitë e pavlefshme do të konsiderohet se është zëvendësuar nga një dispozitë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin e kësaj Garancie.

18. Legjislacioni i zbatueshëm, juridiksioni

18.1 Kjo Garanci i nënshtrohet ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë.

18.2 Vendi i juridiksionit do të jetë Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë. Për më tepër, Garantuesi është përgjegjës para gjykatave të vendit të tij në çdo procedurë ligjore kundër tij.

18.3 Për çdo procedurë në gjykatat gjermane në lidhje me këtë Garanci, Garantuesi cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, Friedrichstraße 231, 10.969 Berlin, si agjentin e tij për shërbimin e padisë apo proceseve të tjera ligjore në lidhje me ndonjë veprim ose procedurë në Gjermani që rrjedh nën këtë Garanci dhe Garantuesi duhet të paraqesë pa vonesë për Huadhënësin konfirmimin e parevokueshëm të agjentit në fjalë të padisë për të kryer funksionin e tillë sipas formës dhe përmbajtjes së dhënë në aneksin E të Marrëveshjes së Huas.

18.4 Garantuesi heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kundërshtim të cilin mund të ketë tani ose në tekstin e mëtejshëm që procedurat e tilla janë sjellë në një formë të papërshtatshme.

18.5 Kjo Marrëveshje Garancie është hartuar në gjuhën angleze në tri kopje origjinale. Deutsche Bank Aktiengesellschaft, Frankfurt am Main do të marrë një prej kopjeve në origjinal.

_____, _____
(vendi) (data)

Për Republikën e Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e saj e Financave

Ministri i Financave

_____
(nënshkrimi ligjërisht detyrues dhe i autorizuar)

Frankfurt am Main, _____
(vendi) (data)

Për Deutsche Bank Aktiengesellschaft

_____
(nënshkrimi ligjërisht detyrues dhe i autorizuar)

MARRËVESHJE HUAJE

NR.1 NDËRMJET RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR, TIRANË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË "HUAMARRËSI" DHE DEUTSCHE BANK AKTIENGESELLSCHAFT, FRANKFURT AM MAIN (HUADHËNËSI"

HYRJE

Në datën 19 mars 2015, Huamarrësi, MINISTRIA E INOVACIONIT DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri, dhe Rohde & Schwarz – Österreich GmbH, Vienna, Austria ("**R&S Austria**") kanë lidhur një kontratë ("**Kontratë Eksporti**") për furnizime dhe shërbime në lidhje me ndërtimin dhe ngritjen e rrjeteve dixhitale të Huamarrësit në Shqipëri ("**Projekti**"). R&S Austria ka deleguar të gjitha kërkesat e saj nga Kontrata e Eksportit tek Rohde & Schwarz GmbH & Co. KG, Mynih, Republika Federale e Gjermanisë ("**Eksportuesi** ").

Shumat totale të Kontratës arrijnë vlerën 21,558,341.82 EURO ("**Vlera Totale e Kontratës**") me origjinë nga Gjermania, Italia dhe shtete të tjera evropiane.

Baza për financimin do të jetë shuma 21,558,341.82 EURO ("http://www.google.al/url?source=transpromo&rs=rssf&q=//translate.google.com/community?source=all**Vlera e drejtë e kontratës")** e Vlerës Totale të Kontratës.

Sipas Kontratës së Eksportit

- dërgesat duhet të kryhen / shërbimet do të ofrohen në periudhën prill 2015-mars 2017

- gatishmëria për funksionimin e stacioneve të ndryshme sipas Projektit është planifikuar të ndodhë në periudhën shtator 2015-mars 2017. Gatishmëria për operimin e Projektit të përgjithshëm është planifikuar të ndodhë maksimumi në muajin mars 2017.

- Vlera e drejtë e kontratës duhet të paguhet si më poshtë:

  10 % paradhënie pas lidhjes së kontratës së eksportit
  5 % paradhënie pas hyrjes në fuqi të kontratës së eksportit
  65 % proporcionalisht për furnizimet
  20 % kundrejt çertifikatave të pranimit në vend

Pjesa e fundit e 85 % e Vlerës së Drejtë që do të financohet nga një hua e lidhur me blerësin për t'u garantuar nga kjo Kontratë Huaje nga Huadhënësi nën mbulimin e huasë së ekspertëve kombëtarë të eksportit ("**Mbulimi HERMES**") të siguruar nga Republika Federale e Gjermanisë, të përfaqësuar nga EULER HERMES Aktiengesellschaft, Hamburg ("**HERMES**"). Për më tepër, Primi për t'u paguar për HERMES për mbulimin HERMES ("**Primi HERMES**") gjithashtu do të financohet nga një hua e tillë e blerësit.

Sipas kushteve paraprake të mësipërme, Huamarrësi dhe Huadhënësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Shumat dhe Qëllimi i Huasë

1.1 Huadhënësi do të vërë në dispozicion të Huamarrësit një hua në monedhën ligjore të vendeve që marrin pjesë në Bashkimin Monetar Evropian ("**EUR**" ose "**Euro**" ose "**Monedha e Huasë**") që nuk tejkalon shumën

20,064,590.55 EURO

(me fjalë: njëzetë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë 55/100) EURO) ("**Huaja**") që përbëhet nga

- "**Pjesa e parë e Huasë 1**" duke arritur shumën deri në 18,324,590.55 EURO për financimin e 85 % të fundit të Vlerës së Drejtë të Kontratës; dhe
- "**Pjesa e dytë e Huasë 2**" duke arritur shumën deri në 1,740,000.00 EURO për financimin deri në 100 % të Primit HERMES;

(secila "**Pjesë e Huasë**", disa "**Pjesët e Huasë**").

1.2 Huaja shërben ekskluzivisht për të financuar e 85 % të fundit të Vlerës së Drejtë të Kontratës plus deri në 100 % të Primit HERMES.

1.3 Huamarrësi përfaqëson dhe garanton se në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Huasë së dhënë më poshtë, ai do të veprojë për llogari të tij ekskluzivisht dhe si përfituesi përfundimtar.

Neni 2

Disbursimi

2.1 Me kusht që Huadhënësi të mos ketë ushtruar ndonjë të drejtë për pezullim ose përfundim sipas nenit 15 të kësaj Marrëveshjeje, çdo disbursim do të kryhet në përputhje me Nën-Nenet e mëposhtme të këtij neni 2, jo më shumë se 5 Ditë Pune Bankare (krahasoni Nën-Nenin 6.2), pasi të gjitha kushtet para disbursimit për pjesën përkatëse të huasë të jenë përmbushur.

2.2 Huaja do të disbursohet vetëm për Eksportuesin kundrejt çertifikatës (ve) **("Kërkesa për disbursim")** të lëshuar/a nga eksportuesi dhe të konfirmuar/a nga dega lokale e Huadhënësit në formën dhe përmbajtjen sipas Aneksit B-1 për dërgesat dhe / ose shërbimet e evidentuara në përputhje me një Letër të udhëzimeve të parevokueshme për Disbursimin e Pagesave **("Lol"),** në formën dhe përmbajtjen sipas Aneksit G të tij.

2.3 Vetëm një disbursim do të kryhet gjatë muajit kalendarik; megjithatë, disbursime të mëtejshme mund të kryhen në të njëjtin muaj kalendarik, nëse çdo disbursim i mëtejshëm arrin të paktën 500,000 Euro.

2.4 Pavarësisht përcaktimeve në Nën - nenet e mësipërme 2.2-2.3, Primi HERMES do të disbursohet sipas Pjesës së dytë të Huasë ose

2.4.1. në mënyrë të drejtpërdrejtë për HERMES pas marrjes nga Huadhënësi të faturës (ve) për Primin HERMES dhe në shumën dhe në maturitetet e përcaktuara në një faturë të tillë (a), në qoftë se të gjitha kushtet para disbursimit sipas kësaj Marrëveshje Huaje për këtë Pjesë të dytë të Huasë të jenë përmbushur në datat e duhura përkatëse, dhe / ose

2.4.2. drejtpërdrejt në një llogari të Huamarrësit me anë të rimbursimit kundrejt çertifikatës së tij të nënshkruar rregullisht (**"Kërkesë për Rimbursim"**) të lëshuar nga Huamarrësi në përputhje me Aneksin B-2 të tij, nëse dhe deri në masën që Primi HERMES është bërë i detyrueshëm dhe i pagueshëm para përmbushjes të të gjitha kushteve paraprake për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje për Pjesën e Dytë të Huasë dhe tashmë është paguar nga Huamarrësi nëpërmjet Huadhënësit

2.5 Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e Huasë pas datës së parë të duhur për shlyerje në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

2.6 Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi vetëm me pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

Neni 3

Periudhat e interesit

3.1 Periudha për të cilën Huaja, në tërësi ose pjesërisht, është e papaguar do të ndahet në periudha të njëpasnjëshme me afat gjashtë muaj (**"Periudha/t e interesit"**) për secilin prej të cilave do të caktohet një normë interesi në pajtim me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Pavarësisht nga dispozitat e Nën-Nenit 3.1 të kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë që të garantojë që të gjitha Periudhat e Interesit të jenë të pajtueshme dhe përfundimisht të korrespondojnë me datat e shlyerjes sipas këtij Neni 7,

a) Periudha e parë e interesit për çdo disbursim do të fillojë në datën në të cilën është kryer disbursimi dhe do të përfundojë në ditën e parë pas një disbursimi të tillë, e cila është gjashtë muaj apo një shumëfish i saj pas datës së lidhjes të kësaj Marrëveshjeje Huaje;

b) Çdo Periudhë pasuese Interesi do të fillojë menjëherë pas përfundimit të Periudhës së mëparshme përkatëse të Interesit dhe do të përfundojë në ditën që bie gjashtë muaj më pas;

c) nëse ndonjë Periudhë Interesi do të përfundojë në një ditë që nuk është Ditë Pune bankare, një Periudhë e tillë Interesi do të zgjatet deri në ditën pasardhëse e cila është një Ditë Pune Bankare në të njëjtin muaj kalendarik ose nëse nuk ka një Ditë Pune Bankare të tillë, Periudha e interesit do të përfundojë në ditën e Punës Bankare të mëparshme;

d) nëse ndonjë Periudhë Interesi ndryshe do të shtyhet pas një date të shlyerjes në pajtim me këtë Nen 7, ajo do të përfundojë në këtë datë të shlyerjes.

Neni 4

Interesi, Paligjshmëria, Mosdisponueshmëria, Mosfunksionimi i Tregut

4.1 Huamarrësi do të paguajë interesin e borxhit në ditën e fundit të çdo Periudhe Interesi ("Data e Pagesës së Interesit") mbi shumën e Huasë me të cilën është e lidhur një Periudhë e tillë Interesi.

4.2 Norma e interesit që do të zbatohet gjatë secilës Periudhë Interesi do të jetë totali i normës 1,55% (një pikë pesëdhjetë e pesë për qind) në vit **("Normë fitimi")** dhe shkallës përkatëse të Normës Ndërbankare të ofruar të Euro-s **("EURIBOR")**, duke qenë shkalla e përqindjes në vit e barabartë me normën për depozitat në Euro për një periudhë të krahasueshme me një periudhë të tillë interesi që shfaqet në faqen Reuters EURIBOR01 (ose pasardhësve ekuivalentë për një faqe të tillë të botuar nga Reuters) në orën 11:00 paradite të kohës së Brukselit në ditën e cila është dy ditë pune bankare para ditës së parë të Periudhës përkatëse të Interesit.

Nëse Periudha përkatëse e Interesit në pajtim me Nën-Nenin 3.2 të kësaj Marrëveshjeje nuk ka saktësisht të njëjtën kohëzgjatje si një periudhë për të cilën një normë është cituar përkatësisht nga Reuters ose Telerate, atëherë EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma mesatare e ponderuar që rezulton nga interpolimi linear i dy EURIBOR-eve në dispozicion për periudhat e menjëhershme më të shkurtra dhe më të gjata, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e Periudhës përkatëse të Interesit.

4.3 Nëse një EURIBOR i tillë është publikuar në një ditë të përcaktimit të normës së interesit, norma e interesit për Periudhën përkatëse të Interesit do të jetë totali i normës së interesit zëvendësues ("Norma e Interesit e Zëvendësimit") dhe Normës së Fitimit.
Norma e Zëvendësimit të Interesit do të jetë norma vjetore të cilën Huadhënësi e vendos si mesatarja aritmetike (nëse është e nevojshme, e rrumbullakosur në normën më të përafërt të një të gjashtëmbëdhjetat për qind (1/16%)) të normave të interesit, të cilat i ofrohen Huadhënësit nga 3 bankat e panelit të depozitavę EURIBOR në Euro për periudhën përkatëse, në orën 11:00 paradite me kohën e Brukselit në ditën e cila është dy Ditë Pune Bankare para ditës së parë të Periudhës përkatëse të Interesit.

4.4 Nëse ndonjë EURIBOR ose Shkalla Zëvendësuese e Interesit, përkatësisht, është nën zero, EURIBOR – i përkatës ose Shkalla Zëvendësuese e Interesit do të konsiderohet të jetë zero.

4.5 Nëse në çdo kohë para fillimit të çdo Periudhe Interesi, Huadhënësi do të ketë vendosur (cili përcaktim do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Huamarrësin) se

a) depozitat në Monedhën e Huasë për kohëzgjatjen e një Periudhe të tillë Interesi nuk janë në dispozicion për Huadhënësin në Tregun përkatës Ndërbankar, në sasi të mjaftueshme në rrjedhën normale të biznesit, ose

a) është e paligjshme për Huadhënësin që të financojë ose të ruajë financimin e çdo disbursimi si më poshtë

Huadhënësi sa më shpejt të jetë e mundur duhet të japë njoftim mbi një vendim të tillë për Huamarrësin duke propozuar një bazë alternative ("Bazat Zëvendësuese"), megjithatë për të garantuar realizimin ose për të ruajtur një disbursim të tillë, HERMES ka rënë dakord për të zgjeruar Mbulimin HERMES mbi termat dhe kushtet kryesisht identike në pajtim me Nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje mbi baza të tilla Zëvendësimi në përputhje me rrethanat.

4.6 Nëse dhe në masën që Huamarrësi nuk e pranon propozimin e Huadhënësit në përputhje me Nën-Nenin 4.4 më sipër, Huadhënësi dhe Huamarrësi do të hyjnë në negociata në mirëbesim për të arritur një zgjidhje që i jep mundësinë Huadhënësit për të ruajtur dhe / ose lëvruar Huanë në bazë të Mbulimit HERMES.

4.7 Nëse dhe në masën që Huadhënësi dhe Huamarrësi nuk bien dakord mbi një zgjidhje në përputhje me Nën-Nenin 4.4 dhe 4.5 më sipër, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të Huadhënësit për vendimin në pajtim me Nën-Nenin 4.4 më sipër, atëherë Huaja do të bëhet e detyrueshme menjëherë në ditën e 30-të dhe Huamarrësi do të shlyejë menjëherë Huanë dhe do të paguajë interesin (të llogaritur në Marzhin e shpenzimeve të tilla siç janë realizuar nga Huadhënësi për të ruajtur Disbursimet e tilla gjatë periudhës nga fundi i Periudhës së fundit të Interesit në lidhje me çdo disbursim deri në datën e shlyerjes) dhe / ose shumave të tjera të pagueshme sipas Marrëveshjes së Huasë (duke përfshirë por pa u kufizuar në shuma të tilla siç është specifikuar në Nën-Nenin 15.2 si rrjedhojë e ndonjë parapagimi të detyrueshëm).

4.8 Në rast se interesi realizohet mbi baza me normë të luhatshme në përputhje me Nën-Nenin 4.2 të kësaj Marrëveshjeje dhe me kostot e Huadhënësit për të marrë depozita që përputhen në tregun përkatës ndërbankar do të jenë më të larta se EURIBOR, atëherë

a) norma e interesit që do të zbatohet gjatë Periudhës përkatëse të Interesit do të jetë norma e përqindjes në vit, e cila është shuma e Marzhit dhe normës së njoftuar Huamarrësit nga Huadhënësi sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast para se interesi të bëhet i pagueshëm në lidhje me atë Periudhë Interesi, që të jetë ai që shprehet si një normë përqindjeje në vit e kostos së Huadhënësit për financimin e huasë nga çfarëdo burim që mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme; dhe
b) Huadhënësi dhe / ose Huamarrësi mund të kërkojë që Huadhënësi dhe Huamarrësi të hyjnë në negociata në mirëbesim për të rënë dakord mbi një bazë zëvendësuese për përcaktimin e normës së interesit të ofruar gjithmonë, megjithatë nëse HERMES ka rënë dakord të zgjasë Mbulimin HERMES në pajtim me Neni 13 të kësaj Marrëveshjeje mbi një bazë të tillë zëvendësuese në përputhje me rrethanat.

4.9 Menjëherë pas çdo përcaktimi të një norme interesi, Huadhënësi duhet të njoftojë Huamarrësin për normën e interesit të përcaktuar në Datën përkatëse të Pagesës së Interesit dhe Interesit të detyrueshëm për tu paguar.

4.10 Me kërkesë nga Huamarrësi, Huadhënësi, mbi një bazë të përpjekjeve më të mira, duhet të ofrojë një normë fikse të interesit për të gjithë shumën e mbetur dhe kohëzgjatjen e mbetur kontraktuale të Huasë, me kusht që:

a) disbursimi i fundit sipas Marrëveshjes së Huasë të jetë kryer dhe që Huaja e përcaktuar të mos jetë më pak se 5,000,000 Euro (me fjalë: pesë milionë Euro);

b) datat për shlyerjen e Huasë mbeten të pandryshuara dhe Aneksi C i Marrëveshjes së Huasë është marrë nga Huadhënësi;

c) norma fikse kërkohet para datës së caktuar të kështit të dytë të shlyerjes në pajtim me këtë Nen 7;

d) në tregun përkatës të kapitalit shumat korresponduese janë në dispozicion për Huadhënësin në maturime korresponduese;

e) kërkesa e Huamarrësit është marrë nga Huadhënësi në 7 Ditë Pune Bankare para datës së ardhshme të shlyerjes së Huasë.

Normë fikse e kuotuar nga Huadhënësi do të jetë totali i Marzhit dhe kostove të rifinancimit të Huadhënësit dhe do të jetë detyruese për të dyja palët me kusht që Huamarrësi të konfirmojë pranimin e tij brenda periudhës së përcaktuar nga Huadhënësi në kuotimin e tij. Në rast mospranimi të tillë nga Huamarrësi, norma e interesit në pajtim me këtë Marrëveshje Huaje do të vazhdojë të zbatohet. Çdo normë fikse e rënë dakord do të bëhet detyruese për periudhën që fillon me datën e ardhshme të shlyerjes dhe duke përfunduar me datën e shlyerjes së fundit në përputhje me Nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje për Huanë dhe interesi i llogaritur do të paguhet në shuma të prapambetura në çdo datë të shlyerjes.

Neni 5

Tarifa e Angazhimit Financiar dhe Tarifa e Menaxhimit

5.1 Për Huanë e patërhequr në çdo kohë, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një tarifë angazhimi financiar në një normë prej 0.75% (me fjalë: zero pikë shtatëdhjetë e pesë për qind) në vit të pagueshëm në shuma të prapambetura tre mujore nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

5.2 Brenda 30 ditëve pas lidhjes së kësaj Marrëveshjeje Huaje por në çdo rast para disbursimit të parë më poshtë, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një tarifë të sheshtë menaxhimi prej 1.0% (me fjalë: një pikë zero për qind) të Huasë.

Neni 6

Llogaritja dhe Dita e Punës Bankare

6.1 Interesi, kamatëvonesa, dëmshpërblimi i shumes totale dhe pagesa e angazhimit financiar do të llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve kalendarike të kaluara dhe një vit prej 360-ditë.

6.2 "**Ditë Pune Bankare**" është (i) një ditë (përveç të shtunës ose të dielës) në të cilën bankat janë të hapura për aktivitet në Frankfurt am Main, ose (ii) në lidhje me çdo datë të caktimit të interesit, pagesa të interesit apo vetëm shlyerje, një ditë në të cilën pagesat në Euro janë vendosur në Sistemin Trans-europian Automatik Ekspres të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale ("**Objekti**").

Neni 7

Shlyerja

7.1 Huaja e disbursuar deri në datën e duhur të kështit të parë të shlyerjes do të shlyhet në 15 këste të barabarta, të njëpasnjëshme, gjashtëmujore, ku kësti i parë i detyrueshëm fillon gjashtë muaj pas datës së gatishmërisë për operimin e Projektit të plotë ("**Pika e fillimit**") - që do të provohet nga një çertifikatë në formë dhe përmbajtje si në Aneksin C, megjithatë maksimumi deri më [25 shtator 2017] ("**Data e Fundit**").

7.2 Sa më shpejt të jetë e mundur, Huadhënësi do t'i dërgojë Huamarrësit një plan për shlyerjen e principalit (të cilat mund të rregullohen në përputhje me Nën-Nenin 7.3 më poshtë) por çdo vonesë apo mosrealizim në asnjë mënyrë nuk ndikon tek detyrimet e Huamarrësit për shlyerjen e kësteve të pagesës si më poshtë.

7.3 Pas marrjes së një çertifikate në formë dhe përmbajtje sipas Aneksit C të kësaj Marrëveshjeje që vërteton se Pika e Fillimit ka ndodhur më shumë se 6 muaj para Datës së Fundit, Huadhënësi ka të drejtë për të rregulluar në përputhje me Pikën e Fillimit duke evidentuar datat e pagesës së mbetur, të përcaktuara në planin e shlyerjes në pajtim me Nën-Nenin 7.2 më sipër. Huadhënësi do t'i dërgojë Huamarrësit një grafik kohor të rregulluar për shlyerjen e principalit, por çdo vonesë apo mosrealizim në asnjë mënyrë nuk ndikon tek detyrimet e Huamarrësit për efekt të kësteve të pagesës si më poshtë.

7.4 Pjesët e Huasë që lëvrohen pas datës së caktuar të kështit të parë të shlyerjes do të paguhen në shuma të barabarta në datat e caktuara për pagesën pas disbursimit të tyre, në mënyrë që kështet e shlyerjes në atë kohë ende të kërkueshme, të rriten përkatësisht.

Neni 8

Parapagimi

8.1 Për sa i përket interesit që realizohet mbi një bazë me normë të luhatshme në përputhje me Nën-nenin 4.2 dhe 4.3 të këtij neni, në ditën e fundit të çdo Periudhe Interesi, Huamarrësi ka të drejtë pas 30 ditëve kalendarike të njoftojë paraprakisht me shkrim Huadhënësin që të parapaguajë çdo pjesë të paktën 1,000,000 EURO (ose shumëfisha të saj), ose të të gjithë huasë së papaguar, në çdo rast, së bashku me interesin e llogaritur mbi të deri në datën e një parapagimi të tillë dhe çdo shumë tjetër të detyrueshme deri në atë kohë.

8.2 Çdo shumë e parapaguar nuk mund të rihuazohet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe do të zbatohet kundrejt kësteve të ardhshme të shlyerjes në mënyrë të anasjellë të maturimit.

8.3 Çdo njoftim i parapagimit të dhënë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje do të jetë i parevokueshëm dhe Huamarrësi do të jetë i detyruar ta parapaguajë në datën e caktuar, në përputhje me çdo njoftim të tillë.

8.4 Për sa i përket interesit të rritur mbi baza me normë fikse në përputhje me Nën-Nenin 4.10 të kësaj Marrëveshjeje, parapagimi do të përjashtohet.

Neni 9

Pagesat

9.1 Detyrimet e pagesave të Huamarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje do të përmbushen vetëm nëse dhe në masën që shumat përkatëse janë kredituar jo më vonë se ora 10:00 sipas kohës lokale, pa ndonjë zbritje për Huadhënësin në llogarinë nr. 0048322 02 të Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main, SWIFT DEUTDEFF / IBAN DE88 5007 0010 0004 8322 02, duke përmendur ref. "ART / Rohde & Schwarz GmbH & Co KG, Në vëmendje të : Z. Emmes", (ose në ndonjë llogari tjetër të njoftuar për Huamarrësin nga Huadhënësi) në dispozicion të lirë të Huadhënësit në monedhën e ligjshme të vendeve pjesëmarrëse në Bashkimin Monetar Evropian. Nëse ndonjë kredi e tillë është realizuar pas një momenti të tillë, përmbushja përkatëse do të ndodhë në Ditën e Punës Bankare Vijuese. Përveç kësaj shpenzimet mund të kërkohen në monedhën në të cilën ato janë kryer. Në këtë rast pagesa do të bëhet në një llogari të tillë, siç Huadhënësi do të udhëzojë Huamarrësin herë pas here.

9.2 Nëse pagesat duhet të bëhen nga Huamarrësi në një ditë që nuk është Ditë Pune Bankare, pagesa përkatëse do të jetë e detyrueshme dhe e pagueshme në Ditën e Punës Bankare të ardhshme në të njëjtin muaj kalendarik, ose nëse nuk ka një Ditë Pune Bankare të tillë, në Ditën e Punës Bankare të fundit dhe do të mbajë interesin deri në datën aktuale të pagesës.

9.3 Huamarrësi nuk ka të drejtë të ushtrojë ndonjë të drejtë të mbajtjes ose kompensimit kundrejt kërkesave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Huaje, përveç nëse pretendimi i Huamarrësit në lidhje me të cilin është zbatuar e drejta e tij për kompensim, nuk është kundërshtuar nga Huadhënësi ose konfirmuar nga një vendim i formës së prerë dhe detyrues nga një gjykatë kompetente.

9.4 Pagesat e marra mund të aplikohen nga Huadhënësi, në diskrecionin e ti, fillimisht për pagesat e vonuara dhe më pas të pagesave të detyrueshme, pavarësisht nga ndonjë udhëzim nga Huamarrësi për të kundërtën.

9.5 Huadhënësi, pa njoftim të mëtejshëm, do të ketë të drejtën të kërkojë me shlyerjen e interesave të vonuara të kësteve në një normë që kalon 2 pikë për qind të normës së

interesit të zbatueshëm në përputhje me Nën-Nenin 4.2 (ose, siç mund të jetë rasti, norma e interesit e zbatueshme në pajtim me Nën-Nenin 4.3) për çdo periudhë interesi sipas neneve 3 dhe 4 të saj, e llogaritur nga data e detyrimit deri në marrjen e pagesës sipas Nën-nenit 9.1. Një kamatëvonesë e tillë do të paguhet pa vonesë pas kërkesës së parë të Huadhënësit.

9.6 Huadhënësi, pa njoftim të mëtejshëm, do të ketë të drejtë të kërkojë shumat e vonuara, përveç dëmshpërblimit të një shume totale të shlyerjes së kësteve në një normë që kalon 2 pikë për qind të normës së interesit të zbatueshme në pajtim me Nën-nenin 4.2 (ose, siç mund të jetë rasti, normën e interesit të zbatueshme në pajtim me Nën-nenin 4.3) për çdo periudhë interesi sipas neneve 3 dhe 4 të saj, e llogaritur nga data e detyrimit deri në marrjen e pagesës sipas Nën-nenit 9.1. Ky Dëmshpërblim i shumës totale do të paguhet pa vonesë pas kërkesës së parë të Huadhënësit.

Neni 10

Ndryshimi i Rrethanave

10.1 Nëse ndodh ndonjë ndryshim në ligj, interpretimi ose aplikimi i tij

a) e bën Huadhënësin subjekt të ndonjë tatimi në lidhje me çdo shumë të pagueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje (përveç taksave të vendosura, të vlerësuara, të vëna ose të mbledhura mbi të ardhurat e përgjithshme neto të Huadhënësit), ose ndryshimet e bazës përkatëse të tatimeve; dhe / ose
b) modifikon ndonjë rezervë dhe / ose kërkesa të veçanta të depozitave të aplikueshme për Huadhënësin; dhe / ose
c) vendos ndaj Huadhënësit ndonjë kosto, shpenzim, detyrim dhe / ose ndonjë kusht tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje;

10.2 dhe si rezultat të ndonjë pike tjetër si më sipër,

a) kostoja e Huadhënësit për të kryer, financuar apo ruajtur ndonjë disbursim ose Hua është rritur; dhe / ose

b) shuma e principalit, interesit ose çdo shumë tjetër e pagueshme Huadhënësit ose kthimi efektiv Huadhënësit si më poshtë është reduktuar; dhe / ose

c) Huadhënësi kryen ndonjë pagesë ose heq dorë nga ndonjë interes apo shumë e pranuar nga Huamarrësi më poshtë;

10.3 atëherë dhe në çdo rast të tillë:

a) Huadhënësi duhet të njoftojë Huamarrësin me shkrim dhe t'i dërgojë Huamarrësit kopjet e të gjitha dokumenteve të cilat provojnë një ndryshim të tillë të rrethanave; dhe
b) që nga përfundimi i Periudhës aktuale të Interesit, me kërkesë, herë pas here nga Huadhënësi, Huamarrësi do të paguajë një shumë të tillë si dhe do të kompensojë Huadhënësin për kosto të tilla në rritje, zvogëlim, pagesa apo interesa të mëparshme ose fitime të tjera (çertifikata e Huadhënësit, në mungesë të një gabimi flagrant, do të jenë përfundimtare).

Neni 11

Tatimet, Taksat, Tarifat dhe Shpenzimet

11.1 Të gjitha taksat, tatimet, tarifat dhe kostot e ngjashme që lindin aktualisht apo në të ardhmen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje do të paguhen nga Huamarrësi.

11.2 Nëse taksat ose tatimet janë zbritur ose janë mbajtur në burim, Huamarrësi do të paguajë shuma të tilla shtesë që janë të nevojshme për të garantuar që në datën e caktuar Huadhënësi do të marrë shumat e plota të detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

11.3 Huamarrësi merr përsipër, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me Huadhënësin, për të paraqitur tek autoritetet e vendit të Huamarrësit çdo deklaratë dhe pagesë të nevojshme në lidhje me këtë. Në këtë mënyrë, Huamarrësi do të shkarkojë Huadhënësin nga çdo detyrim përkatës dhe në fund të çdo viti kalendarik do t'i japë dëshmi Huadhënësit për pagesat e kryera.

11.4 11.4 Çdo shpenzim, duke përfshirë tarifat dhe taksat e avokatëve që lindin, të shkaktuara në lidhje me përgatitjen, nënshkrimin dhe përmbushjen (me përjashtim të shpenzimeve për administrimin e rregullt) të kësaj Marrëveshjeje Huaje do të mbulohen nga Huamarrësi.

11.5 Çdo shpenzim, duke përfshirë tarifat dhe taksat e avokateve që lindin, të kryera në lidhje me ruajtjen dhe / ose konfirmimin dhe /ose zbatimin e të drejtave të Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, do të mbulohen nga Huamarrësi.

Neni 12

Marrëveshje Garancie

Huamarrësi merr përsipër të sigurojë se:

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave,
Bul. "Dëshmorët e Kombit" Nr. 4, Tiranë, Shqipëri ("**Garantuesi**")

do te lidhin një marrëveshje të veçantë garancie **("Marrëveshje Garancie")** me Huadhënësin si kolateral për pretendimet sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje. Kjo Marrëveshje Garancie duhet të jetë në formë dhe përmbajtje sipas Aneksit F bashkëlidhur.

Neni 13

Sigurimi i Kredisë

13.1 Huaja do të vihet në dispozicion nga Huadhënësi në bazë të mbulimit të kredisë së eksportit të siguruar nga Republika Federale e Gjermanisë ("**Mbulimi HERMES**") të përfaqësuar nga EULER HERMES Aktiengesellschaft, Hamburg, sipas pëlqimit të Huadhënësit.

13.2 Huadhënësi ka të drejtë t'i japë informacion autoriteteve kompetente të Republikës Federale të Gjermanisë, Bashkimit Evropian dhe / ose organizatave ndërkombëtare dhe për të lejuar autoritetet e tilla të shqyrtojnë të gjitha të dhënat që mund të lidhen me Huanë, dhe t'u sigurojë atyre kopje.

13.3 Pjesa e dytë e Huasë përfaqëson shumën e barabartë me 100% të Primit HERMES të pritshëm. Në masën që kushtet paraprake për disbursimin për pjesën e Dytë të Huasë

sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje nuk janë plotësuar në datat e duhura të Primit të HERMES, ose kur Huadhënësi ka ushtruar ndonjë të drejtë sipas këtij Neni 15, atëherë, sipas këshillave të Huadhënësit për këtë qëllim, Huamarrësi do të paguajë pa vonesë me anë të Huadhënësit të gjitha shumat për Primin HERMES të cilat janë të nevojshme për të ruajtur Mbulimin HERMES.

13.4 Në masën që Pjesa e Dytë e Huasë nuk është e mjaftueshme për pagesën e 100% të të gjitha faturave të lëshuara nga HERMES për Primin HERMES, atëherë, sipas këshillave të Huadhënësit për këtë qëllim, Huamarrësi do të paguajë pa vonesë, nëpërmjet Huadhënësit çdo shumë shtesë të nevojshme për të ruajtur Mbulimin HERMES, duke qenë një parakusht i domosdoshëm për këtë financim.

13.5 Në masën që Pjesa e dytë e Huasë tejkalon 100% të të gjitha faturave të lëshuara nga HERMES për Primin HERMES, një tepricë e tillë nuk do të jetë më në dispozicion sipas kësaj Marrëveshjeje.

13.6 Në rast se Primi HERMES është rimbursuar (në tërësi ose pjesërisht) nga HERMES për Huadhënësin, Huadhënësi, sipas gjykimit të tij, mund të zbatojë çdo shumë të tillë për çdo sasi të prapambetur ose të detyrueshme më poshtë ose t'i zbatojë në kështin (et) e shlyerjes së mëtejshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje në Datën Pasardhëse të Pagesës së Interesit ose të paguajë çdo rimbursim të tillë për Huamarrësin pa vonesë.

Neni 14

Pasqyrat Financiare, Informacioni, Sipërmarrjet dhe Garancitë

14.1 Deri në kohën kur janë përmbushur të gjitha detyrimet e marra përsipër në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, Huamarrësi:

a) do t'i japë Huadhënësit rregullisht pasqyrat zyrtare vjetore financiare të përcaktuara në përputhje me standardet e zbatueshme të raportimit financiar shqiptar dhe te miratuara në Bordin Administrativ dhe Këshillin Drejtues të Huamarrësit dhe te dorëzuara në Ministrinë e Financave, Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Autoritetin e Mediave Audiovizuale së bashku me llogaritë e fitimeve dhe të humbjeve dhe shënimet shpjeguese pa vonesë pas përfundimit dhe miratimit, dhe pas kërkesës së Huadhënësit do t'i japë çdo të dhënë të hollësishme shtesë. Në rast se përfundimi dhe miratimi është vonuar, Huamarrësi do t'i dorëzojë Huadhënësit shifrat e përkohshme të bilancit brenda nëntë muajve nga fundi i vitit financiar.

b) të njoftojë Huadhënësin pa vonesë për çdo ngjarje të cilat janë me rëndësi në lidhje me këtë Marrëveshjes Huaje ose Garancie;

c) me kërkesën e Huadhënësit, të informojë Huadhënësin për pozicionin financiar të Huamarrësit dhe të përmbushjes sipas kontratës së eksportit;

d) me kërkesën e Huadhënësit, t'i sigurojë menjëherë Huadhënësit (për vete ose në emër të ndonjë drejtëmarrësi të ardhshëm) çdo dokumentacion apo dëshmi tjetër provuese për t'i mundësuar marrësit përkatës të kryeje dhe të jetë i kënaqur me rezultatet e të gjitha procedurave të zbatueshme për të njohur kërkesat e konsumatorëve;

e) të informojë menjëherë Huadhënësin për ndonjë ngjarje ose rrethanë që e bëjnë informacionin e dhënë nga Huamarrësi në lidhje me kërkesat për njohjen e klientëve, të pavërteta ose çorientuese dhe t'i japë Huadhënësit një përditësim përkatës të dokumentacionit apo të dhëna të tjera provuese të ofruara.

14.2 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje, Huamarrësi garanton për këtë Marrëveshje Huaje, për çdo disbursim si më poshtë dhe për kohëzgjatjen e Huasë që është autorizuar nga pikëpamja ligjore dhe statutore për të lidhur dhe përmbushur këtë marrëveshje huaje dhe që për lidhjen, përmbushjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje, çdo autorizim, vendim dhe leje, në veçanti kontroll shkëmbimi ose leje transferimi, sipas një përputhjeje të plotë me ligjet dhe rregullat e vendit të Huamarrësit, kanë qenë ose, në masën që nuk mund të zbatohen për të, do të merren pa kufizim dhe që kjo Marrëveshje Huaje përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të zbatueshëm për Huamarrësin, në përputhje me kushtet e saj. Përveç kësaj, Huamarrësi konfirmon se ai është i autorizuar të hyjë dhe të trajtojë detyrimet ndërkombëtare të Huasë. Huamarrësi merr përsipër të informojë Huadhënësin në masën që sapo garancitë të mos jenë më të zbatueshme dhe të marrë masat e nevojshme që duhet të ndërmerren në mënyrë që Huadhënësi të mos pësojë asnjë disavantazh nga ndryshimi.

14.3 Deri në përmbushjen e plotë të të gjitha detyrimeve të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, Huamarrësi merr përsipër të mos tjetërsohet apo pengoje në mënyrë të plotë ose pjesërisht ose të shesë, te japë me qira, transferojë ose ndryshe të disponojë asetet e financuara nga huaja pa pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

14.4 Huamarrësi garanton se të gjitha detyrimet e tij të pagesave në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje do të renditen të paktën **në mënyrë të barabartë** në çdo kohë, me të gjitha detyrimet e tjera ekzistuese dhe të ardhshme të jashtme të pashtuara (dmth borxh ndaj kreditorëve të huaj) dhe do të sigurohet në mënyrë të barabartë dhe proporcionale, nëse dhe kur Huamarrësi të sigurojë që borxhi tjetër i jashtëm i çdo tarife mbi asetet e tij ose ndonjë nga pasuritë e filialeve të tij'.

14.5 Huamarrësi (i) ndërmerr se as Huamarrësi, as ndonjë nga filialet e tij ose nëpunësit përkatës, drejtorët, punonjësit ose agjentët që veprojnë në emër të tij nuk do të ofrojnë, japin, insistojnë, marrin ose kërkojnë ndonjë pagesë të paligjshme apo avantazh të padrejtë për të ndikuar tek veprimi i çdo personi në lidhje me Projektin dhe (ii) përfaqëson dhe garanton se asnjë nga aktet e lartpërmendura të papërshtatshme apo të paligjshme kanë ndodhur para datës së lidhjes së kësaj Marrëveshjeje Huaje.

Neni 15

Pezullimi i Disbursimit dhe Maturimi i Menjëhershëm

15.1 Huadhënësi ka të drejtë të pezullojë disbursimin dhe / ose të përfundojë këtë Marrëveshje Huaje dhe të kërkojë pagesën e menjëhershme të të gjitha shumave të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, nëse ka ndonjë arsye të rëndësishme për ta bërë këtë, në mënyrë të veçantë nëse:

a) Huamarrësi nuk mund të përmbushë një detyrim të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, kur bëhet i kërkueshëm, ose
b) Huamarrësi nuk mund të përmbushë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, ose
c) Huamarrësi ose Garantuesi nuk paguan ndonjë borxh të jashtëm (p.sh. borxh ndaj kreditorëve të huaj), ose
d) Huamarrësi ose Garantuesi ose vendi i Huamarrësit pranon paaftësinë e tij për të kryer pagesa, konvertime ose transferime, ose Huamarrësi ose Garantuesi hyn në një marrëveshje me kreditorët e tij, ose Huamarrësi i nënshtrohet likuidimit, ose

e) çdo falimentimin, paaftësi paguese, ndërhyrje rregullatore ose procedura të tjera të ngjashme janë krijuar apo aplikuar kundër Huamarrësit, përveç nëse një kërkesë e tillë tërhiqet ose refuzohet brenda 45 ditëve kalendarike pas datës së saj të lëshimit, ose
f) një deklaratë, konfirmim ose informacion i dhënë në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje ose Garancie është ose do të bëhet materialisht i/e pasaktë, jo i/e plotë ose i/e kundërshtuar apo ndonjë kërkesë e këtij Neni 14 është shkelur, ose
g) ka një ndryshim material në pronësinë e Huamarrësit, ose
h) rrethana të jashtëzakonshme janë të pashmangshme, ose ndodhin, të cilat rrezikojnë, vonojnë ose pengojnë përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të Huamarrësit ose të Garantuesit, ose që bëjnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje të paarsyeshëm.

15.2 Në rast se një periudhë rimëkëmbjeje është e zbatueshme në pajtim me Nën-Nenin 15.1, Huadhënësi ka të drejtë të pezullojë disbursimin pa respektimin e kësaj periudhe rimëkëmbjeje, por ka të drejtë t'i japë fund marrëveshjes së huasë dhe të kërkojë pagesën e menjëhershme të të gjitha shumave të pagueshme vetëm pas përfundimit të kësaj periudhe rimëkëmbjeje në fuqi.

15.3 Huamarrësi zhdëmton Huadhënësin kundrejt ndonjë humbjeje ose shpenzimi, të cilat Huadhënësi mund t'i pësojë ose t'i shkaktojë si pasojë e ndonjë parapagimi sipas Nën-Nenit 15.1 të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë por pa u kufizuar tek ndonjë humbje ose shpenzim për shkak të fondeve të huazuara, të kontraktuara ose të përdorura për të financuar ndonjë shumë të pagueshme më poshtë. Një çertifikatë e Huadhënësit e shumës së ndonjë humbjeje ose shpenzimi të tillë, në mungesë të një gabimi flagrant, do të jetë përfundimtare.

Neni 16

Delegimi

16.1 Huamarrësi mund të delegojë të drejtat e tij dhe pretendimet e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje vetëm me pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

16.2 Huadhënësi ka të drejtë të delegojë të drejtat e tij dhe pretendimet e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, në tërësi ose pjesërisht, tek palë të treta pa pëlqimin e Huamarrësit dhe t'i japë informacion në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, siç Huadhënësi do ta çmojë të përshtatshme për çdo drejtëmarrës para dhe pas një delegimi të tillë.

Neni 17

Pavarësia ligjore

Kjo Marrëveshje Huaje është ligjërisht e pavarur nga Kontrata e Eksportit. Në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, Huamarrësi nuk mund të ngrejë asnjë mbrojtje apo kundërshtim që rrjedh nga marrëdhëniet e biznesit të Huamarrësit me Eksportuesin.

Neni 18

Deklaratat

18.1 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje Huaje do të bëhen me shkrim. Nga kjo kërkesë mund të hiqet dorë vetëm nga një marrëveshje me shkrim.

18.2 Të gjitha komunikimet do t'i transmetohen palës përkatëse në adresat e mëposhtme:

Huamarrësi: RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR
Rr. "I. Qemali", Nr. 11
Tiranë, Shqipëri

Telefaks:

Huadhënësi: Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12
D-60325 Frankfurt
Republika Federale e Gjermanisë

Telefaks: +49-69-910-34636, -32610 ose -39765

18.3 Huamarrësi do t'i dorëzojë Huadhënësit një listë të modeleve të nënshkrimeve të personave të autorizuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje Huaje dhe për të lëshuar dhe për ti dhënë Huadhënësit të gjitha dokumentet, deklaratat dhe udhëzimet në emër të Huamarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje. Huamarrësi do të mbajë të përditësuar listën e nënshkrimeve të autorizuara në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje Huaje.

18.4 Ndryshimet e emrave të biznesit, adresat ose të autoritetit për të nënshkruar ose të modeleve të nënshkrimeve sipas listës mbizotëruese në zotërim të palës tjetër, do të jenë detyrues vetëm pas marrjes nga ana e palës tjetër kontraktuese të deklaratave ose dokumenteve, ose të listës së modeleve të autorizuara të nënshkrimeve, përkatësisht, duke informuar mbi një ndryshim të tillë.

18.5 Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten ose komunikimet duhet të kryhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe do të dorëzohen në gjuhën origjinale në anglisht ose gjermanisht, ose në çdo gjuhë tjetër, duhet të shoqërohet me një përkthim në gjuhën angleze të çertifikuar si të saktë nga lëshuesi apo nga një përkthyes i betuar.

Neni 19

Kushtet Pararendëse të Disbursimit

19.1 Disbursimi sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje do të kushtëzohet me marrjen nga Huadhënësi të dokumenteve të mëposhtme të pranueshme dhe pa shpenzime për Huadhënësin:

a) të dhëna provuese (në formën e një opinioni ligjor të dhënë nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, kryesisht në formën e Aneksit D të kësaj Marrëveshjeje Huaje) se Garancia është ekzekutuar në mënyrë të rregullt dhe përbën detyrime ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme të Garantuesit dhe se të gjitha miratimet e nevojshme dhe lejet zyrtare (duke përfshirë kontrollin e shkëmbimit dhe lejet e transferimit) janë marrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë;
b) të dhëna provuese (në mënyrë të veçantë në formën e një opinioni ligjor të dhënë nga një avokat i jashtëm ligjor i pranueshëm për Huadhënësin) se delegimi i kërkesave nga R & S Austria për Eksportuesin është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, është i ligjshëm, i vlefshëm dhe detyrues dhe në fuqi dhe efekt të plotë;

c) të dhëna provuese të autoritetit të Huamarrësit për të nënshkruar këtë Marrëveshje Huaje dhe të Garantuesit për të nxjerrë Garancinë dhe të autoritetit të personave për të nënshkruar dokumente në lidhje me këtë në emër të Huamarrësit ose Garantuesi, përkatësisht, si dhe modele të nënshkrimeve dhe kopjet e pasaportave të nënshkruesve të tillë të autorizuar;

d) konfirmimi i agjentit të procesit në formë dhe përmbajtje sipas Aneksit E të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me Marrëveshjen e Huasë dhe Garancinë;
e) një çertifikatë në formë dhe përmbajtje sipas Aneksit A që vërteton se Kontrata e Eksporti ka hyrë në fuqi;
f) për çdo disbursim sipas Pjesës së Parë të Huasë, Kërkesa (t) për Disbursim në formë dhe përmbajtje sipas Aneksit B-1 kësaj Marrëveshjeje siç përmenden në Nën-Nenin 2.2 të këtij neni në përputhje me LOI në formë dhe përmbajtje si në Aneksin G të kësaj Marrëveshjeje;
g) për çdo disbursim sipas Pjesës së Dytë të Huasë, fatura HERMES siç është përmendur në Nën-nenin 2.4, në rast të një rimbursimi sipas Nën-Nenit 2.4.2 së bashku me Kërkesën për Rimbursim sipas Aneksit B-2, siç është përmendur në Nën-nenin 2.4.2;
h) versionin aktual të statuteve të Huamarrësit me një konfirmim që ky version është i vlefshëm dhe se Huamarrësi do të informojë Huadhënësin pa vonesë për çdo ndryshim;
i) një sipërmarrje nga Eksportuesi në favor të Huadhënësit në lidhje me rreziqe të caktuara që nuk mbulohen nga Mbulimi HERMES;
j) Një sipërmarrje nga Eksportuesi në favor të HERMES në lidhje me përgjegjësinë e Eksportuesit për dorëzime për t'u ofruar nga nën-kontraktuesit e tjerë të Projektit;
k) dokumentet e kërkuara me ligj, rregullore, interpretimi i kujdesshëm i tyre dhe / ose përdorimi bankar gjerman për hapjen e llogarisë përkatëse të huasë së Huamarrësit me Huadhënësin;
l) Marrëveshje Garancie

19.2 Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktuale të vendosur ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit me anë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, Huadhënësi ka të drejtë të mbështetet mbi vërtetësinë e vazhdueshme të pakualifikuar dhe saktësinë e opinioneve ligjore të përcaktuara në Nën-Nenin 19.1 a) dhe b) të këtij neni, përveç nëse Huamarrësi do të ketë informuar për të kundërtën që çdo ndryshim i tillë të informohet pa vonesë, pas ndodhjes së ndryshimit përkatës të fakteve, ligjit dhe / ose juridiksionit.

19.3 Një kusht i mëtejshëm paraprak për çdo disbursim të Huasë është se Mbulimi HERMES në pajtim me nenin 13 është marrë dhe është në fuqi dhe efekt të plotë.

Neni 20

Dispozita të përgjithshme

20.1 Kjo Marrëveshje Huaje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

20.2 Vendi i juridiksionit për të dyja palët do të jetë Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë. Për më tepër, Huamarrësi i nënshtrohet gjykatave të vendbanimit të tij në çdo procedurë ligjore kundër tij.

20.3 Për periudhën për të cilën çdo Hua, në tërësi ose pjesërisht, është e papaguar si më poshtë dhe për çdo procedurë në gjykatat gjermane, Huamarrësi do të sigurojë një agjent për shërbimin e procesit në Republikën Federale të Gjermanisë. Huamarrësi në mënyrë të pakthyeshme emëron Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, Friedrichstrasse 231, 10969 Berlin si një agjent të tillë.

20.4 Nëse, në bazë të një vendimi gjyqësor ose në lidhje me mbledhjen e ekzekutimit, një pagesë do të kryhet në një monedhë të ndryshme nga monedha e ligjshme e vendeve pjesëmarrëse në Bashkimin Monetar Evropian, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë me kërkesën e parë të Huadhënësit, diferencën e mbetur pas konvertimit të menjëhershëm nga Huadhënësi të shumës së marrë në një valutë të tillë në Euro.

20.5 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje Huaje është ose do të bëhet ligjërisht e pavlefshme, dispozitat e tjera të kësaj marrëveshjeje do të mbeten në fuqi. Çdo dispozitë e pavlefshme do të konsiderohet se është zëvendësuar nga një dispozitë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

20.6 As mosushtrimi, as ndonjë ushtrim i pjesshëm i të drejtave të Huadhënësit në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje nuk do të përjashtojë kërkimin e tyre në të ardhmen.

20.7 Secila palë do të marrë një kopje origjinale të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

20.8 Vendi i lidhjes së kësaj Marrëveshjeje Huaje është Frankfurt am Main, Gjermani.

Tiranë, ...
(data)

Frankfurt am Main, ...

RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR

Deutsche Bank AG

Aneksi A

Për
Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12

D-60325 Frankfurt am Main/Gjermani

KONFIRMIMI I HYRJES NË FUQI TË KONTRATËS SË EKSPORTIT

Marrëveshje Huaje Nr. 1 e datës [data] ndërmjet RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR dhe Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main

Ne i referohemi kushteve dhe përkufizimeve të titulluara të Marrëveshjes së Huasë dhe konfirmojmë se Kontrata e Eksportit e lidhur më [datë] hyn në fuqi më . . . . . .

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Rohde & Schwarz Shpk & Co. KG

. . . . . .
(Nënshkrimi/et ligjërisht detyrues/e të Eksportuesit)

Aneksi B-1
(faqe 1)

Për
Deutsche AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12

D-60325 Frankfurt am Main/Gjermani

KËRKESË PËR DISBURSIM Nr. ...

Marrëveshje Huaje Nr. 1 datë [data] ndërmjet RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë dhe Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main

I. Dërgesat / Shërbimet dhe Llogaritja e Shumës së Huasë që do të Disbursohet

Ne i referohemi kushteve dhe përkufizimeve të titulluara të Marrëveshjes së Huasë dhe konfirmojmë se duke iu referuar Vlerës së Drejtë të Kontratës, pagesat janë realizuar / shërbimet janë ofruar si më poshtë:

Data [1,2]	Shuma e Faturës
.... 20..	EURO .....
.... 20..	EURO .....
.... 20..	EURO .....
	Totali EURO .....

Tabela në vijim paraqet me saktësi origjinën e këtyre dërgesave dhe shërbimeve:

	Përshkrimi i dërgesave / Shërbimeve	Vendi i origjinës	Përqindja (%)
1.	.....	.....	.....
2.	.....	.....	.....
3.	.....	.....	.....
Totali			100%

Për më tepër, ne konfirmojmë se kemi marrë të gjitha pagesat e mëposhtme dhe / ose të ndërmjetme të detyrueshme deri tani sipas Kontratës së Eksportit, duke përfshirë, të paktën, 15% të vlerës së të dërgesave / shërbimeve të mësipërme[3].
Shuma ende e kërkueshme sipas Kontratës së Eksportit në bazë të dërgesave / shërbimeve [4] të mësipërme përfaqësojnë ... % të Totalit të Mësipërm të Shumave të Faturës për këto dërgesa / shërbime[5] dhe për ato vlera deri në .....EURO. Ne ju kërkojmë të disbursoni një shumë të tillë në llogarinë tonë nr. ..... tek Deutsche Bank AG (IBAN .....).

---

[1] Të fshihet, sipas rastit.
[2] Një datë e vetme (siç paraqitet p.sh. nga fletëngarkesa, fatura e transportit ajror etj, [dërgesat] ose fatura [shërbimet]) duhet të vendosen këtu. Disa dërgesa /shërbime në të njëjtën datë duhet të mblidhen. Ky Aneks gjithashtu mund të përdoret për dërgesa /shërbime të realizuara / të ofruara në data të ndryshme, p.sh. nëse është e nevojshme për të arritur shumat minimale të parashikuara të disbursimit.
[3] Të fshihet, sipas rastit
[4] Të fshihet sipas rastit.
[5] Të fshihet sipas rastit.

Aneksi B-1
(Faqe 2)

II. Informacion Shtesë

Ne konfirmojmë se

(1) Kontrata e Eksportit është në fuqi dhe efekt të plotë;
(2) Huamarrësi deri tani i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij të pagesës të marra përsipër ndaj nesh sipas Kontratës së Eksportit (kopjet e raporteve të llogarive bankare që evidentojnë pagesat janë bashkëlidhur ose tashmë janë dërguar tek ju) dhe detyrimi i tij për të dhënë garanci, nëse ka, në favorin tonë;
(3) dërgesat / shërbimet[6] e përmendura në këtë Kërkesë për Disbursim janë në përputhje me kontratën e eksportit dhe me dispozitat e Mbulimit HERMES
(4) të gjitha miratimet e nevojshme dhe lejet zyrtare në lidhje me Kontratën e Eksportit janë në fuqi dhe të gjitha rregulloret përkatëse të importit dhe eksportit janë përmbushur;
(5) ne nuk kemi kërkuar më parë disbursim të shumave të cilat formojnë pjesë të kësaj Kërkese për Disbursim.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Rohde & Schwarz GmbH & Co. KG

. . . . . .
(Nënshkrimi/et ligjërisht detyruese të Eksportuesit)

III. Konfirmimi i Deutsche Bank AG

Ne konfirmojmë se dokumentet me një vlerë fature prej . . . . . .EURO dhe që rezulton se i referohet dërgesave / shërbimeve të mësipërme dhe për të përmbushur afatet e një Letre të udhëzimeve të parevokueshme për Disbursimin e Pagesave ("**LoI**") të lëshuara nga Huamarrësi me . . . . . në lidhje me Marrëveshjen e titulluar të Huasë na janë paraqitur për transmetim sipas një LoI të tillë.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Deutsche Bank AG

. . . . . .
(Nënshkrimi/et ligjërisht detyrues/e)

[6] Të fshihet, sipas rastit

Aneksi B-2

Për
Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12

D-60325 Frankfurt am Main/Gjermani

Kërkesë për Rimbursim

Primi HERMES

Marrëveshje Huaje Nr. 1 e datës [data] ndërmjet RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë dhe Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main

Ne i referohemi kushteve dhe përkufizimeve të Marrëveshjes së Huasë dhe për këtë arsye kërkojmë disbursimin e .....EURO sipas Pjesë së Dytë të Huasë, duke qenë Primi HERMES i lidhur me Marrëveshjen e Huasë, e cila është paguar nga ne nëpërmjet jush në .....

Si rrjedhojë, në rimbursim ju kërkohet të disbursoni një shumë të tillë në llogarinë tonë bankare në EURO nr. ..... me ..... (IBAN / SWIFT). Ne nuk kemi kërkuar më parë rimbursim për shumat të cilat bëjnë pjesë të kësaj Kërkese për Rimbursim.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR

.....
(nënshkrimi/et ligjërisht detyrues/e të Huamarrësi)

Aneksi C

Për
Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12

D-60325 Frankfurt am Main/Gjermani

ÇERTIFIKATË E PIKËS SË FILLIMIT

Marrëveshje Huaje Nr. 1 datë [data] ndërmjet RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë dhe Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main

Ne i referohemi termave dhe përkufizimeve të Marrëveshjes së Huasë dhe me anë të kësaj konfirmojmë se gatishmëria për operimin e Projektit të Përgjithshëm të ndërtimit dhe vendosjes/konfigurimit të rrjeteve dixhitale të RADIO DHE TELVIZIONIT SHQIPTAR në Shqipëri u arrit më .....

. . . . . , ...
(vendi) (data)

RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR

. . . . . .
(Nënshkrimi/et ligjërisht detyrues/e të **Huamarrësit)**

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Rohde & Schwarz – Österreich GmbH

. . . . . .
(Nënshkrimi/et i/e ligjshme detyrues/e të **R&S Austria)**

Nëpërmjet kësaj vërtetoj konfirmimin e mësipërm dhe çertifikoj vërtetësinë e nënshkrimeve të mësipërme për Rohde & Schwarz – Österreich GmbH.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Rohde & Schwarz GmbH & Co. KG

. . . . . .
(Nënshkrimi/et ligjërisht detyrues/e të Eksportuesit")

Aneksi D
(Faqe 1)

Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12

D-60262 Frankfurt am Main/Gjermani

OPINION LIGJOR

Të nderuar Zotërinj,

Unë kam shqyrtuar origjinalin e nënshkruar të Marrëveshjes së Huasë së datës [data] ("**Marrëveshja e Huasë**") ndërmjet Radio dhe Televizionit Shqiptar, Tiranë ("**Huamarrësi**") dhe jush dhe të Marrëveshjes së Garancisë të datës .... ("**Garancia**") të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Tiranë **("Garantuesi")** në favorin tuaj sipas nenit 12 të Marrëveshjes së Huasë dhe dokumenteve të tilla, marrëveshjet dhe instrumentet, të gjitha të verifikuara nga ana ime në masën e nevojshme si për fuqinë e tyre, dhe ato ligje, rregullore, vendime, regjistra dhe dokumente të ngjashme që i kam çmuar të nevojshme ose të përshtatshme për qëllime të këtij opinioni, duke përfshirë kopjet e mëposhtme vërtetuara dhe përkthimet e vërtetuara në gjuhën angleze të cilat ndodhen bashkëlidhur:

a. 1. Dokumentet themeluese të Huamarrësit, ne veçanti:
. . . . . ,

2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
. . . . . ,

b. 1.vendim i bordit i Garantuesit i datës
2. dekret i Garantuesit i datës . . . . . .

c. leja e kontrollit të shkëmbimit e lëshuar nga. . . . . datë . . . . . .

d . . . . . ,
. . . . . .

Termat e përdorura në këtë opinion ligjor dhe të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë dhe Marrëveshjen e Garancisë kanë kuptimet që u jepen atyre, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe. Unë supozoj fuqinë ligjore të Marrëveshjes së Huasë dhe Marrëveshjes së Garancisë sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë dhe e jap këtë Opinion Ligjor vetëm në lidhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë ("**ky Shtet**").
Duke u paraqitur paraprakisht dhe nga kjo datë dhe në datat e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë dhe Marrëveshjes së Garancisë, unë jam i mendimit se:

1. Huamarrësi është një ..... [*forma juridike*], i organizuar sipas rregullave dhe që funksionon në formë të vlefshme sipas ligjeve të këtij Shteti, me cilësinë për të paditur dhe për t'u paditur në emër të vet dhe për të zotëruar pasuritë e tyre dhe me kompetencë dhe

autoritet të plotë për të ekzekutuar dhe përmbushur plotësisht detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Huasë.
Sipas.....Garantuesi ka të drejtë të lëshojë Garancinë dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Garancisë, në mënyrë të veçantë: .....

Garantuesi ka cilësi për të paditur dhe për t'u paditur në emër të tij dhe për të zotëruar pasuritë e tij dhe me kompetencë dhe autoritet të plotë për të ekzekutuar dhe përmbushur plotësisht detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Garancisë.

2. Marrëveshja e Huasë është ekzekutuar në mënyrë të rregullt dhe do të dorëzohet për dhe në emër të Huamarrësit nga.....[shënoni emrin....] të emëruar në mënyrë të rregullt dhe i autorizuar për të nënshkruar Marrëveshjen e Huasë duke vepruar si personi i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllime të tilla bazuar në [ju lutem shënoni dokumentin].

   Marrëveshja e Garancisë është ekzekutuar në mënyrë të rregullt dhe do të dorëzohet për dhe në emër të Huamarrësit nga Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë [shënoni emrin....] të emëruar në mënyrë të rregullt dhe të autorizuar për të nënshkruar Marrëveshjen e Garancisë duke vepruar si personi i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllime të tilla bazuar në [ju lutem shënoni dokumentin].

3. Dokumentet do të ekzekutohen në mënyrë të rregullt dhe do të dorëzohen për dhe në emër të Huamarrësit, nëse nënshkruhen nga [shënoni emrin .....] dhe [vendosni emrin] ..... siç përmendet në [ju lutem shënoni dokumentin] sipas [ju lutem shënoni dokumentin e autorizimit] .... (kopja e tij e vërtetuar e cila është bashkëlidhur).

Dokumentet do të ekzekutohen në mënyrë të rregullt dhe do të dorëzohen për dhe në emër të Garantuesit, nëse nënshkruhen nga [shënoni emrin .....] dhe [vendosni emrin] ..... siç përmendet në [ju lutem shënoni dokumentin] sipas [ju lutem shënoni dokumentin e autorizimit] .... (kopja e tij e vërtetuar e cila është bashkëlidhur).

4. Ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e Garancisë nuk bien në kundërshtim ose nuk konstatohen në shkelje të Kushtetutës, ndonjë ligji, rregulloreje, urdhri, dekreti apo vendimi të ndonjë organi legjislativ apo autoriteti, agjencie apo gjykate ose i politikave publike në këtë vend.

5. Të gjitha kërkesat dhe veprimet, si dhe të gjitha vendimet, miratimet, autorizimet, licencat dhe kërkesat e tjera (duke përfshirë pa kufizim çdo kontroll shkëmbimi, konvertim dhe leje transferimi) dhe çdo pullë, regjistrim, publikim dhe shënim nga ose tek autoritetet kompetente të këtij Shteti, të nevojshme ose të këshillueshme për të garantuar se (a) detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë dhe të Garantuesit sipas Marrëveshjes së Garancisë, përkatësisht, janë ligjore, të vlefshme, detyruese, të parevokueshme dhe të zbatueshme, dhe (b) se Marrëveshja e Huasë dhe Garancisë, përkatësisht, janë të pranueshme si dëshmi në këtë Shtet, janë siguruar, plotësuar ose marrë dhe nuk janë objekt i ndonjë kufizimi.

6. Marrëveshja e Huasë dhe Marrëveshja e Garancisë, përkatësisht, përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit dhe Garantuesit, përkatësisht, të zbatueshëm ndaj Huamarrësit dhe Garantuesit në përputhje me kushtet e tyre.

7. Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë dhe të Garantuesit sipas Marrëveshjes së Garancisë, përkatësisht, klasifikohen *pari passu* me të gjitha borxhet e saj të tjera të tashme ose të ardhme të pasiguruara dhe të pashtuara ekzistuese dhe të ardhshme të jashtme (dmth borxhit ndaj kreditorëve të huaj), me uar nga ligji i përgjithshëm i detyrueshëm në këtë vend.

8. Marrëveshja e Huasë nuk është dhe nuk do të bëhet e paligjshme ose e pavlefshme për shkak vetëm të një pavlefshmërie ose paligjshmërie të Kontratës së Eksportit, në veçanti por pa u kufizuar, si pasojë e veprimeve të paligjshme ose të papërshtatshme të Eksportuesit, tek ndonjë prej filialeve, zyrtarëve, drejtorëve, punonjësve ose përfaqësuesve të tij që veprojnë në emër të tij, të shkaktuara me anë të ofrimit, dhënies ose marrjes së ndonjë pagese të paligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm për të ndikuar tek veprimi i ndonjë personi në lidhje me Projektin.
9. Ligji i Republikës Federale të Gjermanisë, pavarësisht nga vendi i nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë dhe Marrëveshjes së Garancisë, përkatësisht, do të zbatohet nga gjykatat në këtë Vend si ligji duhur, nëse duhet të japin një vendim mbi çdo pretendim sipas Marrëveshjes së Huasë ose Marrëveshjes së Garancisë, përkatësisht.

10. Nënshtrimi nga Huamarrësi dhe Garantuesi, ndaj juridiksionit të gjykatave në Republikën Federale të Gjermanisë dhe emërimi i. . . . . si .....i Huamarrësit dhe agjentit të Garantuesit për shërbimin e procesit janë të pakthyeshme, ligjërisht të vlefshme dhe detyruese.

11. Çdo vendim që merret në gjykatat e Republikës Federale të Gjermanisë do të njihet dhe zbatohet nga gjykatat në këtë vend, pa ri-shqyrtimin e themelit të çështjes dhe të heqjes dorë nga Huamarrësi dhe Garantuesi i imunitetit nga padia, sekuestrimi, gjykimi, zbatimi ose procese të tjera juridike në këtë vend, as për vete apo çfarëdo pasurie ose të ardhurave të tyre është ligjërisht i vlefshëm dhe detyrues. Njohja dhe zbatimi i një vendimi të huaj në këtë vend është subjekt i . . . . . .

12. As ekzekutimi dhe përmbushja sipas Marrëveshjes së Huasë ose Marrëveshjes së Garancisë, as çdo pagesë nga ana e Garantuesit nuk sjellin ndonjë tatim apo detyrim në këtë Shtet .

13. Ju nuk jeni dhe nuk do të konsideroheni të jeni rezident, banues, të realizoni ndonjë biznes ose të jeni subjekt i tatimit në këtë vend për shkak vetëm të ekzekutimit, përmbushjes ose zbatimit të Marrëveshjes së Huasë ose për shkak të pranimit, duke bërë një kërkesë apo marrë një pagese sipas Marrëveshjes së Garancisë, përkatësisht. Nuk është e nevojshme ose e këshillueshme që ju të jeni të licencuar, të kualifikuar ose ndryshe të autorizuar për të realizuar një biznes, ose që ju të caktoni agjentë apo përfaqësues në këtë vend.

14. Për më tepër, implikimet dhe/ose konsideratat e mëposhtme ligjore janë të rëndësishme në lidhje me Garancinë:

.....

Unë nuk jam në dijeni se pozicioni aktual ligjor mund të ndryshojë në të ardhmen (nëpërmjet ndryshimit të ligjeve, ndryshimit të juridiksionit ose ndryshe) në mënyrë të tillë që të ndikojë materialisht tek deklaratat në këtë Opinion Ligjor. Megjithatë, nëse kjo ndodh, unë (ose zëvendësi im apo pasuesi) do të plotësoj menjëherë këtë Opinion Ligjor me informacione, dokumente dhe materiale të tjera të rëndësishme ose që kërkohen nga ju në mënyrë specifike. Kjo vlen edhe nëse ju çmoni se sqarimi i mëtejshëm, vërtetimi ose ndryshimi i këtij Opinioni Ligjor është i nevojshëm ose i përshtatshëm.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Ministria e Drejtësisë

. . . . . .
(Nënshkrimi ligjërisht detyrues)

Aneksi E

Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12

D-60325 Frankfurt am Main/Gjermani

Konfirmimi i Agjentit të Procesit

[Marrëveshje Garancie e datës.....ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Tiranë dhe juve në lidhje me][7] Marrëveshjen e Huasë Nr. 1 ndërmjet RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë dhe juve

Konfirmim siç kërkohet nga Nën-Neni 19.1 d) i Marrëveshjes së Huasë /
Konfirmim siç kërkohet nga Nën-Neni 18.3 i Marrëveshjes së Garancisë [8]

Ne jemi emëruar nga [RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR, Tiranë/Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Tiranë][9], si agjenti për shërbimin e procesit në lidhje me çdo procedurë në Gjykatat Gjermane, në lidhje me Marrëveshjen e Huasë/Marrëveshjen e Garancisë më sipër[10].

Ne konfirmojmë se ne kemi qenë të pakufizuar dhe të autorizuar në mënyrë të vlefshme nga [RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR/Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave] për të kryer funksionet e sipërpërmendura dhe që ne jemi në përputhje me to.

Ne do t'iu njoftojmë pa vonesë nëse do të ketë ndonjë ndryshim në emrin ose adresën e shoqërisë sonë në të ardhmen,.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

Ambasada e Republikës së Shqipërisë

. . . . . .
(Nënshkrimi ligjërisht i detyrueshëm i agjentit te procesit)

[7] Të fshihet në rast të Konfirmimit te Agjentit te Procesit për Marrëveshjen e Huasë / që do të përdoret për Konfirmimin ei Agjentit te Procesit për Garancine.
[8] Të fshihet sipas rastit.
[9] Të fshihet sipas rastit
[10] Të fshihet sipas rastit

Aneksi F
(Faqe 1)

MARRËVESHJE GARANCIE

e datës_____

ndërmjet

Deutsche Bank Aktiengesellschaft, Frankfurt am Main

dhe

Republikës së Shqipërisë
("Garantuesi")
të përfaqësuar nga Ministria e saj e Financave, Tiranë

në lidhje me Marrëveshjen e Huasë Nr. 1 në shumën 20,064,590.55 Euro

të datës_____

ndërmjet
Deutsche Bank Aktiengesellschaft, Frankfurt am Main
("Huadhënësi")

dhe
RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë
("Huamarrësi")

për qëllim të
PROJEKTIT TË DIXHITALIZIMIT TË RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR

Aneksi F

Hyrje

Deutsche Bank Aktiengesellschaft, Frankfurt am Main **("Huadhënësi")**, me marrëveshjen e datës_____ **("Marrëveshja e Huasë")** vë në dispozicion të RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë, Republika e Shqipërisë **("Huamarrësi")** një Hua që nuk tejkalon vlerën

20,064,590.55 EURO

(në fjalë: njëzetë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë pesëqind e nëntëdhjetë 55/100 Euro)

kundrejt garancisë sipas kërkesës së parë të Garantuesit. Në përputhje me këtë, Garantuesi lëshon këtë Marrëveshje Garancie, me qëllim që të garantojë se Huadhënësi përfiton rimbursimet e të gjitha shumave të cilat janë përcaktuar se do të rimbursohen nga Huamarrësi, sipas Marrëveshjes së Huasë, në monedhën dhe vendin e parashikuar në Marrëveshje sipas kushteve të maturimit, të përcaktuara apo të përshpejtuara **("Debia"),** duke nënkuptuar shumën neto pa asnjë zbritje apo tatim të çfarëdo natyre dhe pavarësisht rrethanave faktike apo ligjore (duke përfshirë, por pa u kufizuar tek forca madhore apo çdo ngjarje ose veprim që vonon ose pengon shkëmbimin ose transfertat apo arkëtimet nga Huadhënësi në llogarinë për të cilën është rënë dakord nga Huadhënësi) dhe motive për arsye të të cilave Huamarrësi mund të mos kryejë pagesën e Debisë.

Termat dhe kushtet e marrëveshjes së huasë njihen nga Garantuesi. Termat e përdorura në këtë Marrëveshje Garancie dhe të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë përmbajnë kuptimet që u jepen atyre në to, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe.

1. Garancia dhe Shuma e Garantuar

Garantuesi, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar, garanton pagesën për Huadhënësin, në Frankfurt am Main në monedhën e zbatueshme Euro, pjesë e Debisë çdo shumë deri në 22,071,049.60* EURO (me fjalë: njëzet e dy milion e shtatëdhjetë e një mijë e dyzet e nëntë 60/100), duke përfshirë ato shuma që i korrespondojnë interesave dhe të gjitha shumat për të cilat është rënë dakord që të paguhen nga Huamarrësi kundrejt konfirmimit me shkrim nga ana e Huadhënësit ose në rrugë telematike në mënyrë që shuma e kërkuar nga Garantuesi sipas kësaj marrëveshjeje të jetë e barabartë me debinë që nuk ka paguar Huamarrësi. Pagesa, sipas kësaj marrëveshjeje, do të depozitohet në llogarinë e Huadhënësit me nr. 0048322 02 në Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main, Swift DEUTDEFF / IBAN DE88 5007 0010 0004 8322 02, (ref.. "RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR, Marrëveshja e Huasë Nr. 1, Rohde & Schwarz GmbH & Co. KG, Në vëmendje të: Z. Emmes") ose në

një llogari tjetër të njoftuar nga Huadhënësi, në Euro, pa asnjë zbritje apo shume të mbajtur.

2. Pagesa me Kërkesë të Parë

Garantuesi krediton menjëherë shumën, sipas kësaj Marrëveshjeje, në momentin e kërkesës së parë nga Huadhënësi dhe konfirmimit, me shkrim ose në rrugë telematike, që shuma që i kërkohet Garantuesit të jetë e barabartë me Debinë (ose me një pjesë të saj) të cilën Huamarrësit nuk e ka shlyer në afatin e maturimit.

3. Detyrimi Parësor, i Pavarur

Kjo Marrëveshje Garancie përbën detyrimin parësor dhe të pavarur të Garantuesit për të rimbursuar Huadhënësin në përputhje me kushtet e saj, në të gjitha rrethanat, pavarësisht vlefshmërisë, ligjshmërisë apo zbatueshmërisë së Marrëveshjes së Huasë dhe pavarësisht të gjitha kundërshtimeve, përjashtimeve apo mbrojtjeve nga ana e Huamarrësit apo palëve të treta.

4. Garancia për Rimbursim

Huadhënësit nuk i kërkohet fillimisht të pretendojë rimbursim, të ngrejë padi kundër, apo të ekzekutojë ndonjë pretendim apo garanci të dhënë nga Huamarrësi ose çdo person tjetër para se të bëjë kërkesë nga Garantuesi sipas Marrëveshjes.

5. Përjashtimi i Mbrojtjeve Specifike

Kjo Marrëveshje Garancie dhe detyrimet e Garantuesit sipas saj nuk kushtëzohen nga marrëdhënia ligjore midis Huamarrësit dhe Huadhënësit dhe janë të pavarura dhe të zbatueshme pavarësisht nga:

a. çdo e metë në dispozitat e Marrëveshjes së Huasë,

b. çdo mungesë apo mangësi në vendimet e korporatës në lidhje me Debinë,

c. çdo përfaqësim i pamjaftueshëm i Huamarrësit,

d. çdo mungesë licencash apo autorizimesh të tjera ose çdo pengesë apo kufizime faktike apo ligjore që ekzistojnë apo paraqiten në shtetin e Huamarrësit (duke përfshirë por pa u kufizuar tek forca madhore ose çdo ngjarje apo veprim që vonon apo pengon shndërrimet në transferta apo arkëtime nga Huadhënësi në llogarinë për të cilën është rënë dakord nga Huadhënësi),

e. çdo marrëveshje e lidhur ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit që lidhet me Debinë, duke përfshirë të gjitha zgjatjet e afatit të rimbursimit dhe çdo riskedulim apo ristrukturim të Debisë, pavarësisht nëse Garantuesi ka dhënë pëlqimin e tij,

f. marrja, ekzistenca, ndryshimi apo çlirimi i çdo kolaterali tjetër që i është lëshuar Huamarrësit për Debinë, dhe marrëdhënia ligjore e Huamarrësit me çdo ofrues të kolateralit të sipërpërmendur,

g. çdo e drejtë e Huamarrësit për të zgjidhur Marrëveshjen e Huasë, dhe

h. çdo e drejtë që Huadhënësi mund të ketë për kompensimin e Debisë kundrejt një kundërpretendimi të Huamarrësit.

6. Tatimet

Çdo shumë që paguan Garantuesi sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet e çliruar dhe e shlyer dhe pa asnjë zbritje të tatimeve të mbajtura në burim. Tatimet e mbajtura në burim janë tatime, tarifa apo taksa qeveritare të çfarëdo natyre, të cilat vendosen apo mblidhen nga ose në emër të shtetit të Garantuesit dhe që zbriten nga çdo rimbursim sipas kësaj marrëveshje dhe / ose sipas Marrëveshjes së Huasë. Në rast se zbritja e tatimeve të mbajtura në burim kërkohet me ligj, atëherë Garantuesi paguan ato shuma shtesë që mund të jenë të nevojshme, me qëllim që shumat neto të marra nga Huadhënësi pas zbritjeve të jenë të barabarta me shumën që do të merrej nëse një zbritje e tillë nuk do të kërkohej.

7. Kompensimi i Monedhës

Pagesat e kryera nga Garantuesi ndaj Huadhënësit, në zbatim të një vendimi ose urdhri të lëshuar nga gjykata penale ose administrative, në monedhë të ndryshme nga ajo e Garancisë **("Monedha e Garancisë")** përbën përmbushje të detyrimit të Garantuesit vetëm në masën që shuma e Monedhës së Garancisë të cilën Huadhënësi, menjëherë pas marrjes së rimbursimit në monedhën në fjalë, do të ishte i aftë të blinte me shumën e marrë në këtë mënyrë në një treg të njohur të këmbimit valutor. Në rast se një shumë e tillë do të ishte më e vogël se shuma e detyruar e shprehur në Monedhën e Garancisë sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, në atë kohë si një detyrim më vete dhe i pavarur, që bëhet shkak për ngritje pretendimi, Garantuesi ka detyrimin të paguajë diferencën.

8. Kufizimi i kalimit të përgjegjësive

Në masën që Debia nuk është shlyer dhe ka mbetur pa u rimbursuar ndonjë shumë, sipas Marrëveshjes së Huasë, Garantuesi nuk merr përsipër të ngrejë pretendimet që mund të ketë kundër Huamarrësit për arsye të ushtrimit të detyrimeve të Garantuesit sipas kësaj Marrëveshje Garancie, qoftë sipas kontratës apo ligjit, derisa Debia të shlyhet dhe të gjitha shumat që i detyrohen Huadhënësit sipas Marrëveshjes së Huasë të merren apo kompensohen plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme. Çdo shumë që Garantuesi arkëton apo kompenson nga Huamarrësi mbahet në garanci mirëbesimi dhe i paguhet menjëherë Huadhënësit. Në rast se Garantuesi paguan Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje, Garantuesi do të kalohet në të drejtat e Huadhënësit kundrejt Huamarrësit pasi Debia të jetë shlyer dhe të gjitha shumat që i takojnë Huadhënësit sipas Marrëveshjes së Huasë të jenë marrë apo kompensuar plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme nga Huadhënësi.

9. Shpërndarja/ Ndryshimi i Strukturës

Detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie mbeten në fuqi pavarësisht shpërndarjes ose ndryshimit në strukturën apo formën juridike të Huamarrësit.

10. Ristrukturimi

Huadhënësi, pa pëlqimin e Garantuesit, gëzon të drejtën e riskedulimit apo ristrukturimit të principalit, interesave dhe shumave të tjera të detyrueshme sipas Marrëveshjes së Huasë, të çlirojë Huadhënësin nga detyrimet e tij dhe/ose të pranojë një debitor të ri nëse, për arsye të cilat Huadhënësi i çmon të rëndësishme, Huadhënësi ose shoqëritë e tjera të grupit Deutche Bank bien dakord për masa të ngjashme edhe për sa i përket Huadhënësit ose kreditë e tyre të tjera të shtrira tek entet në shtetin e Huamarrësit. Këto masa nuk ndryshojnë përgjegjësinë e Garantuesit sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, dhe Garantuesi merr përsipër t'i paguajë plotësisht Huadhënësit me kërkesë të parë, në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje, të gjitha shumat dhe në një afat të tillë sikur të ishin maturuar nëse Marrëveshja e Huasë dhe Debia do të kishin mbetur në fuqi dhe të pandryshuara. Garantuesi nuk është i detyruar të japë pëlqimin në lidhje me kushtet dhe dokumentacionin e riskedulimit, ristrukturimit, çlirimit apo sipërmarrjes së borxhit.

11. Para të Reja

Nëse Huadhënësi bie dakord në lidhje me ristrukturimin e borxhit apo për të shmangur një ristrukturim të tillë, për t'i dhënë Huamarrësit kredi të reja **("Para të Reja")** ose enteve të tjera të sektorit publik apo privat në vendin e Huamarrësit dhe nëse pjesëmarrja e Huadhënësit në Para të Reja do të llogaritej mbi bazën e kredive të reja të dhëna nga Huadhënësi dhe/apo shoqëri të tjera të grupit të Deutche Bank për Huamarrësin apo ente të tjera, Garantuesi garanton në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, atë pjesë të pretendimeve për principalin, interesat, kostot, shpenzimet, tarifat dhe shuma të tjera që duhen paguar në lidhje me Paratë e Reja nëpërmjet të cilave është rritur pjesëmarrja e Huadhënësit në Paratë e Reja në përputhje me Debinë, pavarësisht nëse Huadhënësi është i detyruar me ligj për të marrë pjesë në ristrukturimin e Parave të Reja. Në këtë rast, kërkohet pëlqimi i Garantuesit për kushtet e dokumentacionit të Parave të Reja.

12. Informacioni

12.1 Garantuesi i jep Huadhënësit një listë firmash të autorizuara të personave të autorizuar për të bërë të gjitha deklaratat për Huadhënësin në emër të Garantuesit, në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie. Garantuesi duhet gjithmonë të mbajë të përditësuar listën e firmave të autorizuara.

12.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje Garancie bëhen dhe vendosen vetëm me shkrim. Nga kjo kërkesë mund të hiqet dorë vetëm me marrëveshje me shkrim.

Të gjitha deklaratat dhe njoftimet komunikohen nëpërmjet shkresave ose me transmetim elektronik në adresat e mëposhtme :

Për Garantuesin: Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave

Rr. "I. Qemali", Nr. 11 Tiranë, Shqipëri

Telefaks: [për t'u vendosur]

ose për Huadhënësin: Deutsche Bank AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12 D-60325 Frankfurt
Republika Federale e Gjermanisë
Telefaks: +49-69-910-34636, -32610 ose -39765

Çdo ndryshim në emrat dhe adresat e mësipërme të biznesit do të jetë detyrues vetëm pas marrjes nga Huadhënësi ose nga Garantuesi, përkatësisht, të njoftimit ose dokumenteve që evidentojnë një ndryshim të tillë.

12.3 Garantuesi njofton Huadhënësin pa vonesë për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë zbatimin e duhur të Marrëveshjes së lidhur të Huasë ose të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

12.4 Derisa të gjitha detyrimet e marra përsipër në lidhje me Marrëveshjen e Huasë të jenë përmbushur, Garantuesi do t'i japë Huadhënësit rregullisht

12.4.1. sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda 180 ditëve pas përfundimit të çdo viti financiar, një kopje të raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për atë vit financiar;

12.4.2. sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda muajit dhjetor të vitit të mëparshëm, buxhetin shtetëror vjetor të Garantuesit për çdo vit kalendarik;

12.4.3. sapo të jetë i disponueshëm, por në çdo rast brenda 180 ditëve pas përfundimit të çdo viti financiar, pasqyrat financiare të Garantuesit për secilin vit financiar, duke përfshirë informacion në detaje të arsyeshme në lidhje me

a) bilancin ndërkombëtar të pagesave të Garantuesit për atë vit financiar ;

b) (i) titujt (mbajtjet) zyrtarë prej ari, (ii) SDR (*Të Drejtat Speciale të Tërheqjes*), (iii) Pozicionet e Rezervave në Fond, (iv) Kursin e Këmbimit Valutor i cili është në pronësi ose mbahet nga Garantuesi, Banka e Shqipërisë apo ndonjë autoritet tjetër monetar i Garantuesit (SDR-të, Pozicionet e Rezervave në Fond dhe Kursi i Këmbimit Valutor do të interpretohen sipas kuptimit të dhënë atyre nga FMN-ja) dhe (v) shumën (siç është raportuar nga Banka e Shqipërisë) e borxhit të jashtëm të Garantuesit në fund të atij viti financiar; dhe

c) produktin e brendshëm bruto të Garantuesit për atë vit financiar (duke përfshirë ndarjet sipas sektorëve).

13. Transferimi

Huadhënësi ka të drejtë të transferojë të drejtat dhe pretendimet e tij të pagesave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Garancie së bashku me pretendimet përkatëse sipas Marrëveshjes së Huasë, në tërësi ose pjesërisht, tek palë të treta pa pëlqimin e Garantuesit dhe të japë çdo informacion të nevojshëm për ta, para dhe pas çdo transferimi.

14. Marrja e përgjegjësive

14.1 Garantuesi siguron që të gjitha detyrimet e tij të rimbursimit në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie renditen të paktën **të barabarta**, në çdo kohë, me të gjitha debitë

e jashtme, të vjetra, aktuale apo të ardhme, (d.m.th., debi ndaj kreditorëve të huaj). Nëse dhe në masën që Garantuesi siguron debi të jashtme nëpërmjet një pengu mbi asetet e tij apo asetet e filialeve të tij, atëherë Garantuesi merr përsipër të sigurojë debinë, në mënyrë të barabartë dhe me përqindje, nëpërmjet pengut mbi asetet e tij apo aseteve të filialeve të tij ose nëpërmjet çdo kolaterali tjetër që pranohet nga Huadhënësi.

14.2 Garantuesi (i) merr përsipër se as Garantuesi dhe as ndonjë nga filialet e tij ose zyrtarët përkatës, drejtorët, punonjësit ose agjentët që veprojnë në emër të tij nuk do të ofrojnë, japin, insistojnë në, marrin ose kërkojnë ndonjë pagesë të paligjshme apo avantazh të padrejtë për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi në lidhje me Projektin dhe (ii) deklaron dhe garanton se asnjë nga veprimet e papërshtatshme apo të paligjshme të lartpërmendura nuk ka ndodhur para datës së lëshimit të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

14.3 Garantuesi kupton se çështjet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Garancie janë veprime private dhe tregtare sipas legjislacionit gjerman. Për shkak të faktit se Garantuesi është Sovrani i Republikës së Shqipërisë dhe në masën që Garantuesi, në çdo juridiksion, mund të gëzojë të drejtën, për vete apo për asetet e veta apo fitimet, për të pretenduar imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi (qoftë i lidhur me ekzekutimin, para dhënies së një gjykimi ose akordimeve apo vendime të tjera) ose procese të tjera gjyqësore, duke përfshirë, në lidhje me zbatimin e vendimit të arbitrazhit, dhe për aq sa një imunitet i tillë (pavarësisht nëse pretendohet) mund t'i atribuohet Garantuesit, në një juridiksion të tillë ose aseteve apo të ardhurave të tij, atëherë Garantuesi, sipas kësaj Marrëveshjeje, bie dakord në mënyrë të pakthyeshme që të mos pretendojë një imunitet të tillë dhe, me anë të kësaj Marrëveshjeje, e heq këtë imunitet në shkallën më të plotë që e lejojnë ligjet e juridiksionit në fjalë. Nëpërmjet një përjashtimi, Huadhënësi nuk heq imunitetin në lidhje me ekzekutimin e një vendimi të arbitrazhit që lidhet me (i) "godinat e misionit" aktuale apo të ardhme, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, "godinat konsullore" aktuale apo të ardhshme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose të tjera që përdoren nga misioni diplomatik i Shqipërisë, (ii) çdo pasuri të paluajtshme, sipas parashikimeve të nenit 3 , paragrafët 1-3, të Ligjit shqiptar nr.8743 të datës 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, dhe (iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është maturuar dhe shlyer në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas të drejtës publike, traktateve ndërkombëtare, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

14.4 Të gjitha taksat, tarifat dhe shpenzimet e tjera në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie (të tilla si taksat dhe tarifat e avokatëve), duke përfshirë kostot që lindin në lidhje me ndonjë detyrim të kësaj Marrëveshjeje të Garancisë, do të përballohen nga Garantuesi. Tatimet e lartpërmendura, tarifat dhe shpenzimet duhet të dokumentohen në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësi.

15. Të ndryshme

Garantuesi përfaqëson dhe garanton se kjo Marrëveshje Garancie është e detyrueshme, e vlefshme dhe e zbatueshme ndaj Garantuesit, në përputhje me kushtet e saj. Garantuesi konfirmon se ai ka ndërmarrë dhe do të vazhdojë të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se çdo shumë e pretenduar nga Huadhënësi nga Garantuesi mund të transferohet tek Huadhënësi menjëherë, pa asnjë lloj zbritje, kosto ose tarifa të tjera. Garantuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar informacion nga Huadhënësi në lidhje me Marrëveshjen e Huasë dhe Debinë.

16. Afati

Kjo Garanci hyn në fuqi që nga data e lëshimit të saj dhe përfundon pasi të gjitha shumat e shprehura të jenë të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin si rezultat i borxhit, të jenë pranuar plotësisht dhe në mënyrë të pakthyeshme nga Huadhënësi.
Megjithatë, në rast se pas kësaj Huadhënësit i lind përgjegjësia për të kthyer paratë e marra në pagesën e borxhit, si rezultat i ndonjë falimentimi, likuidimi ose procedure të ngjashme që ndikon tek Huamarrësi, kjo Garanci do të rivendoset në afat dhe do të hyjë në fuqi përsëri pavarësisht skadimit të afatit.

17. Pavlefshmëria e Pjesshme

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Garancie do të jetë e pazbatueshme ose e pavlefshme, dispozitat e tjera të saj do të mbeten në fuqi. Çdo dispozitë e pavlefshme do të konsiderohet se është zëvendësuar nga një dispozitë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin e kësaj Garancie.

18. Legjislacioni i Zbatueshëm, Juridiksioni

18.1 Kjo Garanci i nënshtrohet ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë.
18.2 Vendi i juridiksionit do të jetë Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë. Për më tepër, Garantuesi është përgjegjës para gjykatave të vendit të tij në çdo procedurë ligjore kundër tij.
18.3 Për çdo procedurë në gjykatat gjermane në lidhje me këtë Garanci, Garantuesi cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, Friedrichstraße 231, 10.969 Berlin, si agjentin e tij për shërbimin e padisë apo proceseve të tjera ligjore në lidhje me ndonjë veprim ose procedurë në Gjermani që rrjedh nën këtë Garanci dhe Garantuesi duhet të paraqesë pa vonesë për Huadhënësin konfirmimin e parevokueshëm të agjentit në fjalë të padisë për të kryer funksionin e tillë sipas formës dhe përmbajtjes së dhënë në Aneksin E të Marrëveshjes së Huasë.
18.4 Garantuesi heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kundërshtim të cilin mund të ketë tani ose në tekstin e mëtejshëm që procedurat e tilla janë sjellë në një formë të papërshtatshme.
18.5 Kjo Marrëveshje Garancie është hartuar në gjuhën angleze në tre kopje origjinale. Deutsche Bank Aktiengesellschaft, Frankfurt am Main do të marrë një prej kopjeve në origjinal.

_____, _____
(vendi) (data)

Për Republikën e Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e saj e Financave

Ministri i Financave

_____
(Nënshkrimi ligjërisht detyrues dhe i autorizuar)

Frankfurt am Main, _____
(vendi) (data)

Për Deutsche Bank Aktiengesellschaft

Aneksi G

Deutsche Bank
AG
Structured Trade & Export Finance
Taunusanlage 12
D-60325 Frankfurt am Main/Gjermani

LETËR E UDHËZIMEVE TË PAREVOKUESHME PËR DISBURSIMIN E PAGESAVE

Marrëveshje Huaje Nr. 1 e datës [data] ndërmjet RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tiranë dhe Deutsche Bank AG, Frankfurt am Main.
Ne i referohemi Marrëveshjes së Huasë (duke përfshirë përkufizimet e saj) sipas Nën-Nenit 2.2 të të cilës Pjesa e parë e Huasë do të disbursohet kundrejt çertifikatave të lëshuara nga Eksportuesi dhe të konfirmuara nga dega juaj lokale, në formë dhe përmbajtje sipas Aneksit B-1 duke iu referuar dërgesave/shërbimeve të kryera dhe dokumenteve të caktuara që do të paraqiten në lidhje me këtë.

Në bazë të kushteve paraprake të kësaj Marrëveshjeje, ne në mënyrë të pakthyeshme ju udhëzojmë, duke vepruar nëpërmjet degës tuaj lokale, për të nxjerrë ndonjë konfirmim të tillë për çdo Kërkesë të tillë për Dsbursim, nëse kjo degë ka marrë nga ose në emër të Eksportuesit, dokumentet e mëposhtme dhe ka konstatuar se këto dokumente të paraqitura siç shfaqen, janë në përputhje me kushtet e mëposhtme dhe Procedurat Doganore Uniforme dhe Praktikën për Kreditë Dokumentare/Letër Kreditë, ICC-Publikimi Nr. 600 (paraqitja me vonesë është e pranueshme):
65 % e Vlerës së Drejtë së Kontratës deri në 14,012,922.18 EURO të pagueshme në mënyrë proporcionale për furnizimet kundrejt:

1. Faturës tregtare të nënshkruar të lëshuar nga Eksportuesi ose R&S Austria në emër të RADIO TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tirana në 1 origjinal dhe 2 kopje në mënyrë proporcionale për furnizimet, duke iu referuar ndërtimit dhe ngritjes së rrjetit dixhital të Huamarrësit në Shqipëri
2. Lista e ambalazhimit në 1 origjinal dhe 2 kopje
3. CMR dhe / ose AWB në 1 origjinal dhe 2 kopje origjinale
4. Certifikata e Përkohshme e Pranimit në 1 kopje të nënshkruar nga përkatësisht RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR, Tiranë dhe Eksportuesi ose R&S Austria.

20 % e Vlerës së Drejtë të kontratës deri në 4,311,668.36 EURO e pagueshme pas pranimit në vend kundrejt:

1. Faturës tregtare të lëshuar nga Eksportuesi ose R&S Austria në emër të RADIO DHE TELEVIZIONIT SHQIPTAR, Tirana në 1 kopje dhe 2 origjinale në mënyrë proporcionale për furnizime, duke iu referuar ndërtimit dhe ngritjes së rrjetit dixhital të Huamarrësit në Shqipëri
2. Çertifikatës së Pranimit të Produkteve të Dorëzueshme në Vendpunim në 1 kopje të nënshkruar përkatësisht nga RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR, Tiranë dhe Eksportuesi ose R&S Austria

3. Miratimi me shkrim në 1 kopje të nënshkruar nga RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR, Tiranë, me kusht që dokumentet në përputhje me termat dhe kushtet e këtyre udhëzimeve të pakthyeshme të shoqëruara me Kërkesën e kërkuar për Disbursim, të jenë paraqitur në degën tuaj lokale. Kjo është udhëzuar këtu në mënyrë të parevokueshme për të transmetuar Kërkesën përkatëse për Disbursim, nëse është plotësuar siç duhet, me konfirmimin e saj të duhur për ju pa vonesë dhe për tu transmetuar, së bashku me një fotokopje të Kërkesës për Disbursim, dokumente të tillë pa vonesë me postë tokësore dhe detare në adresën e mëposhtme: ....

Së fundi, me anë të kësaj në mënyrë të pakthyeshme autorizojmë dhe ju udhëzojmë juve si Huadhënës sipas Marrëveshjes së Huasë për disbursimin e shumës, disbursimi i të cilës kërkohet në çdo Kërkesë për Disbursim të tillë të plotësuar siç duhet, për Eksportuesin ose me porosi të tij, në pajtim me nenin 2 të Marrëveshjes së Huasë, dhe të debitojë llogarinë tonë të huasë me ju në përputhje me rrethanat.

Tarifa e Trajtimit për kontrollin e dokumenteve është 0,275% mbi shumën e faturës së paraqitur. Minimumi 250,00 EURO per grupin e dokumenteve do të jetë për llogari të Huamarrësit. Kjo tarifë përfshin këshillimin, ndryshimin dhe tarifat postare.

Kjo letër do të jetë pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Huasë. Ju lutem informoni Eksportuesin që ju keni marrë këtë Udhëzim të Pakthyeshëm për Disbursimin e Pagesave.

. . . . . , ...
(vendi) (data)

RADIO DHE TELEVIZIONI SHQIPTAR

. . . . . .
(Nënshkrimi ligjërisht detyrues i Huamarrësit)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë